# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7156
E mërkurë, 3 prill 2024
Çmimi 0. 50


## Ali Ahmeti, "Qytetar Nderi i Prizrenit"

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# BE-ja: KOSOVA E RREZIKON RRUGËTIMIN EVROPIAN NËSE S'E THEMELON ASOCIACIONIN

FAQE 5



Bashkimi Evropian ka përsëritur kërkesën që Kosova duhet ta zbatojë urgjentisht detyrimin shumëvjeçar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, përndryshe ka paralajmëruar se ajo do të përballet me pasoja në rrugën e saj drejt BE-së. Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, ka theksuar se themelimi i Asociacionit është detyrim për Kosovën dhe "kjo është përsëritur disa herë nga Bashkimi Evropian në nivelin më të lartë - atë të liderëve evropianë"

## AKTUALE



### PËR ÇFARË SHPENZOHEN NË SHBA FONDET QË MIRATOHEN PËR UKRAINËN?

F. 2

### OSMANI BISEDON ME O'BRIENIN PËR ANËTARËSIM NË KIE DHE DIALOGUN ME SERBINË

F. 5

### AKSIDENTOHET NJË VETURË ME EMIGRANTË NË SHQIPËRI, 8 TË VDEKUR

F. 3

## EKONOMI



### ULEN PËR 8 % TARIFAT E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR ATA QË SHPENZOJNË MBI 800 KWH

F. 5

### PROTESTË E PUNËTORËVE TË TELEKOMIT PAS BLLOKIMIT TË LLOGARISË SË KOMPANISË

F. 8

### BIEN EKSPORTET: PRODHUESIT THONË SE KANË KËRKESA, POR JO KUSHTE

F. 8



### KURTI PËRKUJTON MASAKRËN E KRALANIT: PËRGJEGJËSIA DHE E VËRTETA NDODHEN NË ARKIVAT E BEOGRADIT ZYRTAR

F. 7



## SPORT



### I LINDUR NË GJERMANI E RRITUR NË KOSOVË, HISTORIA E SUKSESIT TË EDON ZHEGROVËS

F. 11


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# Një fëmijë i vrarë pas të shtënave në Finlandë, i dyshuari është në mbajtje



HELSINKI, 2 PRILL - Një fëmijë ka vdekur dhe dy të tjerë janë plagosur seriozisht si pasojë e të shtënave në një shkollë në Finlandë, ka thënë policia.
Sipas zhytarëve policorë, tri viktimat janë të moshës 12-vjeçare, ashtu sikurse i dyshuari, i cili fillimisht ka ikur, por më pas është ndaluar nga autoritetet.
Prindërit u kanë thënë medieve finlandeze se të shtënat kanë ndodhur në një klasë në shkollën Viertola në Vantaa, në veri të kryeqytetit Helsinki.
Policia ka thënë se ka arritur në shkollë brenda nëntë minutave.
Shkolla i ka rreth 800 nxënës nga klasa e parë deri tel e nënta, si dhe një staf prej 90 njerëzve, sipas autoriteteve lokale.
Finlanda është përballur me incidente të tilla edhe në të kaluarën.
Më 2007, Pekka-Eric Auvinen i vrau shtatë nxënës, infermieren e shkollës, drejtorin dhe veten me një pushkë dore në shkollën e mesme "Jokela", afër Helsinkit.
Një vit më vonë, më 2008, Matti Saari, një tjetër student, shtiu me armë në një shkollë profesionale në veriperëndim të Finlandës. Ai i vrau nëntë studentë, një anëtar të stafit të shkollës dhe pastaj veten.
Finlanda e ka ashpërsuar ligjin për armëmbajtjen më 2010. Ajo e ndryshoi edhe moshën e lejuar për armëmbajtje, nga 18 në 20 vjeç.

# Irani zotohet për hakmarrje, pas sulmit në Damask për të cilin e fajëson Izraelin

TEHERAN, 2 PRILL - Teherani është zotuar se do të hakmerret, pasi shtatë njerëz, përfshirë një komandant të lartë të Trupave të Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC), u vranë nga një sulm ajror në konsullatën iraniane në Damask të hënën.
Irani e ka fajësuar Izraelin për këtë sulm.
Lideri suprem i Iranit, Ayatollah Ali Khamenei, tha të martën se do ta bëjnë Izraelin të "pendohet" për sulmin ndaj kompleksit të Ambasadës së Iranit në Damask, ku u vra gjenerali Mohammad Reza Zahedi, komandant i lartë i trupave të IRGC-së, si dhe gjashtë persona të tjerë që besohet se janë pjesëtarë të IRGC-së.
Izraeli nuk ka thënë se e kreu këtë sulm, edhe pse e ka rritur fushatën e sulmeve ajrore mbi caqet e lidhura me Iranin prej se e nisi luftën më 7 tetor në Rripin e Gazës kundër Hamasit - grupit të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.
Hamasi mbështetet nga Teherani.
Sulmi ndaj ndërtesës ngjitur me ndërtesën kryesore të Ambasadës së Iranit në Damask më 1 prill i ka rritur shqetësimet se konflikti në Gazë mund të përhapet në tërë rajonin.
Burimet ushtarake thanë se raketat izraelite u shkrepën nga largësitë e uzurpuara të Golanit dhe se sistemi mbrojtës raketor i Sirisë i interceptoi disa nga to, por disa të tjera e goditën cakun, duke e "shkatërruar plotësisht ndërtesën" dhe duke i vrarë dhe plagosur "të gjithë që ishin brenda".
Irani, megjithatë, tha se konsullata u godit nga gjashtë raketa të shkrepura nga avionët luftarakë F35.
Izraeli, sipas praktikës së vet të zakonshme, nuk e ka komentuar sulmin, por agjencia e lajmeve "Reuters" e citoi një zyrtar të lartë të qeverisë izraelite duke thënë në kushte anonime se ata që u goditën "kanë qenë përgjegjës për shumë sulme ndaj aseteve izraelite dhe amerikane dhe se



kishin plane për sulme shtesë".
Shtëpia e Bardhë tha se është e vetëdijshme për këtë ngjarje.
Zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Mattheë Miller, tha se Uashingtoni "është i shqetësuar për çdo gjë që do të ishte përshkallëzuese, apo që shkakton rritje të konfliktit në rajon".
Ambasadori i Iranit në Damask, Hossein Akbar, tha për televizionin sirian se pesë deri në shtatë persona janë vrarë nga ky sulm.
Ministria e Mbrojtjes e Sirisë tha se Izraeli e sulmoi konsullatën dhe se "të gjithë ata që ishin të pranishëm në ndërtesë u vranë apo plagosën".
Teherani ka një prani të madhe ushtarake në Siri, derisa Izraeli ka kryer sulm të kohëpaskohshme kundër zonave të lidhura me Iranin në këtë vend, shpesh duke i vënë në shënjestër komandantët e IRGC-së.

# Për çfarë shpenzohen në ShBA fondet që miratohen për Ukrainën?

UASHINGTON, 2 PRILL - Kongresi amerikan nuk arriti të vendosë përpara fillimit të pushimeve të pranverës për ndihmat e reja për Ukrainën dhe vendet e tjera aleate.
Republikanët që e kundërshtojnë propozimin për ndihmat thonë se Kongresi duhet të caktojë më shumë fonde për çështjet e brendshme. Por, siç njofton "Zëri i Amerikës", projektligji për ndihmat ka një ndikim shumë më të madh brenda vendit nga ç'mund ta mendojnë amerikanët.
Ukraina thotë se humbjet rishtazi në terren janë për shkak të mangësive në armatime.
Në Shtetet e Bashkuara, Dhoma e Përfaqësuesve me shumicë republikane nuk ka miratuar ndihma të reja për Kievin dhe nuk ka futur për votim projektligjin për



këtë çështje. Projektligji, që u miratua më parë nga Senati, parashikon 60 miliardë dollarë fonde për Ukrainën. "Askush nuk është dakord me veprimet e Putinit. Por, kur marrim paratë e fituara me mund nga taksapaguesit dhe i dërgojmë 8 mijë kilometra larg, pa ndonjë shpresë se po shkohet drejt mbylljes së konfliktit dhe ndërkohë kufiri ynë është krejtësisht i hapur dhe amerikanët po vriten në rrugët e tyre - ky është një problem", tha ligjvënësi republikan Scott Perry.
Por, shumica e fondeve që janë miratuar për Ukrainën nuk kanë shkuar drejtpërsëdrejti atje. Ato janë shpenzuar në Shtetet e Bashkuara, si tek fabrika e gjendur në zonën elektorale të ligjvënësit Perry në York, të Pensilvanisë, ku prodhohen armatime të reja për t'i zëvendësuar rezervat që po i dërgohen Kievit.
Fabrika në York është një ndër dhjetëra objektet e industrisë ushtarake që po financohet nga fondet në mbështetje të Ukrainës.
"Zërit të Amerikës" iu lejua hyrja në Fabrikën e Municioneve të Ushtrisë në Scranton, rreth tre orë larg qytetit York, për të parë nga afër se si shpenzohen paratë e taksapaguesve.
Këtu shufrat prej çeliku shkrihen për t'u bërë predha artilerie të kalibrit 155 mm. Ato kontrollohen me kujdes dhe lyhen për ta parandaluar ndryshkjen përpara se të mbushen me lëndë eksplozive.
Prodhimi në Pensilvani është dyfishuar, nga 14 mijë predha të tilla që prodhoheshin në muaj përpara fillimit të luftës në Ukrainë, në gati 28 mijë predha në muaj që prodhohen tani. Kompania kontraktore General Dynamics thotë se numri do të arrijë në 36 mijë në muaj kur të fillojë pas pak javëve prodhimi në një fabrikë të re aty pranë.
Dyqind vende të reja pune priten të hapen vetëm në këtë fabrikë, por zyrtarët e kompanisë General Dynamics i thanë Zërit të Amerikës se kjo nuk mund të ndodhë pa u miratuar financimi i mëtejshëm nga Kongresi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kurti: Numri i punëkërkuesve nga radhët e komuniteteve është rritur për 1/3 në krahasim me vitin e kaluar

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 2 prill - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se në vitin e dytë të qeverisjes krijuan një Fond të veçantë për komunitetet joshumicë në vlerën prej 3 milionë eurosh. Ai ka thënë se përmes tij financuan 259 grante për fermerë, ndërmarrës të rinj dhe OJQ me qëllim nxitjen e punësimit te këto komunitete. “Një vit më herët mbështetëm 123 projekte për biznese të vogla dhe ndërmarrëse nga radhët e të gjitha komuniteteve. Kurse këtë vit lansuam masën e veçantë të punësimit për 2,000 punëkërkues që jetojnë në komunat e Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut. Atje tashmë kemi hapur Zyre të Punësimit dhe Zyrat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve. Te këto të fundit, së fundmi janë regjistruar mbi 50 biznese të reja”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Ai ka thënë se komunitetet joshumicë përbëjnë 17 % të subvencioneve të Ministrisë së Ekonomisë për pajisje efiçiente në kuadër të masave për efiçiencë të energjisë. “Ato gjithashtu përbëjnë 9% të praktikantëve me pagesë përmes programit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve ‘Kosova Generation Unlimited’, përqindje kjo përfaqësuese në raport me tërësinë e popullatës”, ka shkruar ai.



Kurti ka theksuar se në kuadër të Programit të Stabilizimit të Komuniteteve, në bashkëpunim me Bashkimin Evropian, Ministria për Komunitete dhe Kthim ka zbatuar 415 projekte të ndryshme përmes të cilave janë siguruar 543 vende të reja të punës, prej tyre 328 me orar të plotë, pjesa tjetër me orar të pjesshëm. “Në bashkëpunim me Bashkimin Evropian gjithashtu janë ndërtuar ose rinovuar 116 shtëpi, për të siguruar kështu kthim të qëndrueshëm për komunitetet joshumicë. E përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, kemi ndarë edhe 3 milionë euro për ndërtimin dhe rinovimin e shtëpive bashkë me 4 milionë tjera gjatë viteve 2021-2024 për projekte infrastrukturore prej të cilave përfitojnë veçanërisht pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në komuna të vendit tonë”, ka shkruar Kurti.

Ai ka shtuar se kanë themeluar grupin ndërinstitucional për Promovimin e Punësimit të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve. Sipas Kurtit, të dhënat e Agjencisë së Punësimit për vitin që lëmë pas tregojnë se numri i punëkërkuesve nga radhët e këtyre komuniteteve që kanë gjetur punë është rritur për 1/3 në krahasim me vitin pararendës.

“Nga viti i kaluar gjithashtu kemi filluar për herë të parë me transmetimin e drejtpërdrejtë të mbledhjeve të Qeverisë në gjuhën serbe, krahas respektimit të ligjit për përdorim të gjuhëve në komunikata për media dhe njoftimet nga Zyra e Kryeministrit. Në fund të vitit të kaluar miratuam Strategjinë për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre, dokument që u hartua dhe miratua për herë të parë e që ndër të tjera parasheh integrimin më të qëndrueshëm dhe përfaqësimin më proporcional në jetën institucionale të komuniteteve joshumicë”, ka shtuar Kurti.

# Aksidentohet një veturë me emigrantë në Shqipëri, 8 të vdekur

Tiranë, 2 prill - Tetë persona kanë vdekur të martën herët kur një veturë e cila dyshohet se po bartte emigrantë doli nga rruga dhe ra buzë një lumi në jug të Shqipërisë, njoftoi Policia shqiptare.

Kreu i Prokurorisë së Gjirokastrës, Petrit Çano, tha se shoferi është shqiptar nga qyteti veriperëndimor, Shkodër, ndërsa emigrantët nga vende të treta që po përdornin Shqipërinë për të shkuar në vende të Bashkimit Evropian. “Nuk e dimë nga [cilat vende] vijnë, presim mjekët ligjorë nga Tirana për ekspertizën dhe do të duhet kohë për identifikimin. Pas identifikimit do të bashkëpunojmë me ambasadat përkatëse për kthimin e trupave në vendet e tyre”, tha Çano për medie.



Aksidenti ndodhi rreth orës 4:00 në rrugën Këlcyrë - Përmet në jug të vendit.

Policia tha se drejtuesi i veturës, i cili po i bartte shtatë emigrantë të jashtëligjshëm, e humbi kontrollin mbi timonin dhe doli nga rruga duke rënë buzë lumit Vjosa.

Policia tha se hasi një veturë që po udhëtonte me shpejtësi të madhe dhe se ajo i kishte shpërfillur urdhrat e oficerëve për t’u ndalur, duke vazhduar drejt Përmetit.

Oficerët e ndoqën deri në afërsi të vendit të ngjarjes veturën dhe se “kur nuk e kanë parë më mjetin që po ndiqnin, efektivët e policisë kanë inspektuar zonën dhe kanë parë shenjat e aksidentit të rëndë”, tha për media drejtori i Policisë së Gjirokastrës, Ardian Çipa.

Paraprakisht, Policia kishte thënë se shtatë emigrantët e paligjshëm së bashku me shoferin humbën jetën në vendin e ngjarjes.

Drejtues të policisë vendore, të policisë kufitare dhe dy grupe të Forcës Kombëtare të Sigurisë dolën në vendngjarje për t’i sqaruar rrethanat dhe shkaqet e aksidentit.

Cipa dhe Cano thanë se gjatë aksit rrugor Këlcyrë - Përmet në vazhdimësi janë vërejtur "elemente kriminale që merren me këtë aktivitet", me transportimin e paligjshëm të emigrantëve që synojnë të shkojnë drejt BE-së.

Shqipëria është pjesë e rrugës ballkanike që e përdorin emigrantë të paligjshëm për të shkuar drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

Ata hyjnë në territorin shqiptar nga Greqia dhe më pas udhëtojnë drejt Malit të Zi në përpjekje për të arritur në BE.

Sipas Agjencisë Evropiane Kufitare, Frontex, viti 2023 shënoi një rritje rekorde të hyrjeve të parregullta të emigrantëve në BE përmes rrugës ballkanike.

## Konjufca në takim me delegacionin parlamentar të Shqipërisë thekson nevojën e një dinamike të re të bashkëpunimit

Prishtinë, 2 prill - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, Ardian Gola, priti të martën në takim Komisionin për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të drejtuar nga Flutura Açka. Në takim Konjufca vlerësoi lart bashkëpunimin që Kosova dhe Shqipëria kanë ndërmjet vete, duke e konsideruar atë shembull për vendet e tjera në rajon.

Kryetari i Kuvendit shprehu interesimin dhe gatishmërinë për t’i vazhduar marrëdhëniet e tilla me Tiranën në të gjitha fushat, duke i kultivuar dhe intensifikuar më tej ato, në të mirë të të dyja vendeve, veçanërisht në rrafshin parlamentar.

Konjufca theksoi nevojën e një dinamike të re të bashkëpunimit midis dy vendeve tona, përfshirë këtu sferën e arsimit, si njërën nga shtyllat kryesore të zhvillimit, për të rezultuar me arsim cilësor dhe konkurrues në tregun global.

Anëtarët e delegacionit parlamentar nga Shqipëria falënderuan kryetarin Konjufca për pritjen e ngrohtë dhe shprehën interesimin e tyre për t’i rritur angazhimet në funksion të kooperimit sa më të madh ndërparlamentar midis Kosovës dhe Shqipërisë.



Në takim u sugjeruan vizita më të shpeshta të ndërsjella të komisioneve parlamentare, për të kontribuuar sa më shumë si në përafrimin dhe avancimin e legjislacionit, ashtu edhe të këmbimit të përvojave parlamentare.



# BE-ja: Kosova e rrezikon rrugëtimin evropian nëse s'e themelon Asociacionin

Bashkimi Evropian ka përsëritur kërkesën që Kosova duhet ta zbatojë urgjentisht detyrimin shumëvjeçar për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, përndryshe ka paralajmëruar se ajo do të përballet me pasoja në rrugën e saj drejt BE-së. Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, ka theksuar se themelimi i Asociacionit është detyrim për Kosovën dhe "kjo është përsëritur disa herë nga Bashkimi Evropian në nivelin më të lartë - atë të liderëve evropianë"

Prishtinë, 2 prill - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, ka thënë të martën se Kosova duhet ta zbatojë urgjentisht detyrimin shumëvjeçar për themelimin e një Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe në vend dhe paralajmëroi se ajo do të përballet me pasoja në rrugën e saj drejt BE-së, nëse dështon ta bëjë këtë. Ai tha se themelimi i Asociacionit është detyrim për Kosovën dhe "kjo është përsëritur disa herë nga Bashkimi Evropian në nivelin më të lartë, atë të liderëve evropianë".

Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Por, më 2015, Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjeti se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Në fund të vitit të kaluar bashkësia ndërkombëtare ua paraqiti palëve një draft për statutin që do të kishte ky asociacion. Palët, fillimisht, thanë se e pranojnë në parim, por nuk kanë bërë asnjë hap përpara.

Në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" më 19 mars, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se nuk e ka pranuar këtë draft-statut.

Stano e përsëriti se themelimi i Asociacionit lidhet me përparimin e Kosovës në synimin e saj për t'u bërë pjesë e bllokut. "Nëse Kosova nuk është në gjendje të japë rezultate në këtë drejtim, atëherë nuk do të shihet si sinjal pozitiv se ajo dëshiron të lëvizë në rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve [me Serbinë], që tash është i lidhur me përparimin e Kosovës në rrugën drejt BE-së", shtoi ai.

Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe vazhdojnë të ngulin këmbë se Kosova është e detyruar ta themelojë Asociacionin.

Stano theksoi se çështja e themelimit të Asociacionit vazhdimisht diskutohet në takimet me palët. Megjithatë, ai tha se në takimin e kësaj jave në nivel të kryenegociatorëve të Kosovës dhe Serbisë, çështja kryesore do të jetë gjetja e një zgjidhjeje për dinarin e ndaluar serb në Kosovë. Ai tha se bisedimet e javës së kaluar shënuan përparim dhe se ato do të vazhdojnë të enjten e 4 prillit në Bruksel.

Përdorimi i dinarit për pagesa me para të gatshme në Kosovë u ndalua më 1 shkurt, kur Banka Qendrore e Kosovës e futi në fuqi një rregullore të re e cila përcaktoi euron si valutën e vetme zyrtare në vend.

Kjo çështje, pos që zemëroi Serbinë, nxiti mospajtime edhe në mes të Qeverisë së Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, pasi komuniteti serb në Kosovë, prej vitesh, merr pagesa në dinarë nga buxheti i Serbisë.

Diplomatë perëndimorë i kërkuan Kosovës ta pezullojë rregulloren për t'u dhënë kohë qytetarëve të prekur të përshtaten me praktikën e re.

## Ministrja Gërvalla takon homologen e Japonisë, në fokus thellimi i marrëdhënieve bilaterale dhe bashkëpunimi ekonomik

Prishtinë, 2 prill - Thellimi i marrëdhënieve bilaterale në mes të Republikës së Kosovës dhe Japonisë, mbështetja për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, bashkëpunimi në realizimin e projekteve dhe investimeve kapitale dhe strategjike ishin temat kyçe të takimit që zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, pati me ministren e Punëve të Jashtme të Japonisë, Yoko Kamikawa.

Gjatë këtij takimi ministrja Gërvalla shprehu falënderimet e saj për mbështetjen e madhe që Japonia i ka dhënë Kosovës në shumë fusha, si në rindërtim, zhvillim ekonomik, arsim dhe proceset integruese.

Më tutje, ministrja Gërvalla e njoftoi homologen e saj rreth progresit që Republika e Kosovës ka arritur në demokratizim, sundim të ligjit, zhvillim ekonomik, respektim të të drejtave të njeriut etj.

Me ministren e Jashtme të Japonisë, ministrja Gërvalla foli edhe për zhvillimin e njohurive të teknologjisë informatike dhe digjitalizimit, duke u pajtuar për angazhim të përbashkët për realizimin e projekteve konkrete që për synim kanë tërheqjen e investimeve japoneze, krijimin e mundësive të punësimit të të rinjve dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.



## Ali Ahmeti, "Qytetar Nderi i Prizrenit"



**Prizren, 2 prill** - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, është shpallur të martën qytetar nderi nga Kuvendi Komunal i Prizrenit. Në një seancë të asamblesë komunale, asamblistët kanë votuar që Ahmeti të shpallet "Qytetar Nderi".

Gjatë ceremonisë, për të numëruar të arriturat e jetës dhe veprimtarisë së Ali Ahmetit, përveç kryetarit të komunës, Shaqir Totaj, fjalë rasti patën edhe përfaqësues të të gjitha partive politike në Kosovë, përfshirë këtu Vetëvendosjen, LDK-në, PDK-në, AAK-në si dhe përfaqësues nga partitë e komunitetit turk dhe boshnjak.

Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, tha se sot është një moment i rëndësishëm dhe se vetë vepra e Ali Ahmetit flet. "Është moment i rëndësishëm ky i sotshmi për të shpallur qytetar nderi z. Ali Ahmeti dhe për këtë iniciativë nuk kemi pasur asnjë dyshim, ndaj ne si qytet i lidhjes dimë të nderojmë njerëz të kalibrit si z. Ahmeti. Pse të nderohet Ali Ahmeti? Sepse vetë vepra e tij flet. Ai njihet për historinë e tij në luftë e në politikë në Maqedoni dhe rajon. Thonë se kohët e vështira krijojnë njerëz të fortë dhe njerëzit e fortë ndryshojnë rrethanat dhe punojnë shumë, e ne në këtë rast kemi të bëjmë me një person të fortë. Ne nuk ndalemi, prandaj është privilegj për mua që me vendim unanim të Asamblesë së Prizrenit të shpallim z. Ahmeti 'Qytetar Nderi'", tha Totaj.

Duke falënderuar kryetarin Totaj dhe asamblistët komunalë, kryetari Ahmeti tha se lidhja na e ka mbajtur shpirtin gjallë, edhe pas lidhjes. "Na e ka mbajtur shpirtin gjallë sepse na mësoi se si të mos etemi të ndërtojmë program deri në çlirim, sepse vetë lidhja e Prizrenit ishte një platformë për zhvillimin e tokave shqiptare", ka thënë Ahmeti.

# Osmani bisedon me O'Brienin për anëtarësim në KiE dhe dialogun me Serbinë



**Prishtinë, 2 prill** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe ndihmëssekretari amerikan i Shtetit për Evropën dhe Euroazinë, James O'Brien, biseduan më 1 prill për rregulloret monetare në Kosovë dhe për zbatimin e marrëveshjeve të arritura ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në dialogun e Brukselit.

O'Brien shkroi në rrjetin social "X" se "ne biseduam për rëndësinë e zbatimit të rregulloreve monetare, në mënyrë që ato të jenë në dobi të të gjithë qytetarëve kosovarë, përfshirë të komunitetit pakicë serb".

Banka Qendrore e Kosovës e vendosi më 1 shkurt një rregullore të re duke e përcaktuar euron si valutën e vetme zyrtare në vend, duke e ndaluar kështu përdorimin e dinarit serb.

Shtetet e Bashkuara i kanë kërkuar Kosovës ta pezullojë rregulloren për t'u dhënë kohë qytetarëve të prekur që të përshtaten me praktikën e re.

Paraprakisht, duke e quajtur këtë telefonatë produktive, Osmani tha se kanë diskutuar hapat e Kosovës drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës, ku Kosova ka aplikuar në vitin 2022.

Në një postim në "X" ajo bëri me dije se kanë biseduar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Theksova rëndësinë themelore të punës së bashku me aleatët tanë të ShBA-së në mbrojtjen e lirisë, pavarësisë dhe demokracisë sonë", shkroi Osmani.

Komiteti për Politikë dhe Demokraci i Këshillit të Evropës më 27 mars ka miratuar raportin e raportueses për Kosovën, Dora Bakoyannis, ku rekomandohet që shteti ka përmbushur kushtet për t'u bërë anëtare e plotë e Këshillit të Evropës.

Hapi i radhës, sipas këtij komiteti, do të jetë më 18 prill, kur do të hidhet në votim ky raport para Asamblesë Parlamentare në përbërjen e saj të plotë.

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës do të ishte katalizator që "Kosova të vazhdonte të bënte përparim në forcimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit si dhe t'i adresojë sfidat dhe çështjet shqetësuese", tha Komiteti për Politikë dhe Demokraci.

Profesori i Universitetit "Johns Hopkins" në ShBA, Edward Joseph, ka komentuar bisedën e fundit në mes të presidentes Vjosa Osmani me ndihmëssekretarin amerikan James O'Brien. "Në bisedën e tyre, O'Brien dhe Osmani dërguan secili një sinjal të fortë për rreshtimin ShBA - Kosovë në çështjet kyçe. Në një moment të rëndësishëm të marrëdhënies së tyre, është koha të vendoset në tryezë një vizitë në Zyrën Ovale për presidenten Osmani", ka shkruar Joseph në "X".

## Ulen për 8 % tarifat e energjisë elektrike për ata që shpenzojnë mbi 800 kWh




**Prishtinë, 2 prill** - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) ka njoftuar për disa ndryshime në tarifat e energjisë elektrike. Sipas njoftimit të ZRrE-së, është vendosur për uljen e tarifave prej 8-përqindësh për konsumatorët familjarë për bllokun me konsum mbi 800kWh. "Rënia e çmimeve në tregjet e energjisë elektrike në Evropë ka ndikuar në kostot me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, kostot e furnizimit me energji elektrike nga importi për konsumatorët fundor për vitin 2024 parashihen të jenë më të ulëta në krahasim me vitet e paraprake. Këto ndryshime kanë ndikuar në uljen e tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët fundor si vijon: Ulje e tarifave prej 8% për konsumatorët familjarë për bllokun me konsum mbi 800kWh. Ulje e tarifave prej 3% për konsumatorët komercial dhe industrial", ka njoftuar ZRrE-ja.

Në njoftim theksohet se Bordi i Zyrës së Rregullatorit ka aprovuar edhe tarifat për vitin relevant tarifor 2024 për Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (KEDS). Në këtë seancë, Bordi ka shqyrtuar rezultatet e fituara nga vlerësimi i koncentrimit të tregut të energjisë elektrike në Kosovë përmes indeksit HHI (Herfindahl–Hirschman Index) për vitin 2023, i cili tregon qartë se kemi të bëjmë me një përqendrim të lartë në tregun e energjisë elektrike, nga ku shihet mungesa e furnizuesve aktivë. Bazuar në rezultatet e këtij raporti, Bordi ka vendosur që Obligimi i Shërbimit Universal për dy vitet e ardhshme t'i ngarkohet KESCO-s.

## Latifi përkujton 9 dëshmorët dhe 34 martirët e Hoçës së Vogël



RAHOVEC, 2 PRILL - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, bashkë me familjarë, përfaqësues të OVL-së, bashkëluftëtarë e qytetarë të shumtë, kanë nderuar të martën sakrificën e 9 dëshmorëve dhe të 34 martirëve nga Hoça e Vogël. "Ky fshat i vogël, por me zemër të madhe, e pagoi shtrenjtë çmimin e lirisë, sepse hordhitë serbe mësynë mbi popullin e paarmatosur, më 2 prill të vitit '99, duke vrarë gra e fëmijë, të rinj e pleq dhe duke shkretuar gjithçka që u dilte përpara. Prandaj, këto varre bëjnë që lidhja jonë me tokën të jetë më e fuqishme dhe ne nuk do ta harrojmë kurrë gjakun e derdhur dhe vajin e fëmijëve e lotin e nënave mbi varre. Lavdi e përjetshme atyre që u flijuan për liri!", ka thënë kryetari Latifi.

# 9 milionë euro investime në infrastrukturën rrugore të Gjilanit

GJILAN, 2 PRILL - Investimet në infrastrukturën rrugore të komunës së Gjilanit po përmirësohen dita-ditës. Për ndërtimin, asfaltimin, zgjerimin e mirëmbajtjen e rrugëve, ujësjellësit, kanalizimit, trotuareve, ndriçimit publik dhe shtimin e sipërfaqeve gjelbëruese dhe terreneve sportive në vitin paraprak ishin mbi 9 milionë euro.
Mentor Mihovci, drejtor për Shërbime Publike, Infrastrukturë e Banim në Komunën e Gjilanit, tha se janë duke bërë investime milionëshe në infrastrukturën rrugore. Sipas tij, këto investime po bëhen prej fshatrave e drejt qendrës së qytetit, duke kthyer perspektivën edhe në pjesët rurale etj. "9 milionë e 21 mijë e 495.29 euro është vlera investimeve. Kjo po bëhet me qëllim për të krijuar jetë më të mirë për qytetarët", tha Mihovci.
Më tej ai shtoi se gjatë vitit të kaluar janë realizuar dhjetëra projekte. Po ashtu, edhe sivjet kanë nisur të realizohen me qëllim të ngritjes së ofrimit të shërbimeve për qytetarët.




Krahas infrastrukturës rrugore, janë realizuar projekte edhe në infrastrukturën tjetër bazike në ujësjellës, ndriçim, gjelbërim, kanalizime dhe punë të tjera. Sipas drejtorit, për këto projekte me bashkëfinancim për vitin 2023 janë investuar 5 milionë e 581 mijë e 856.93 euro. Projekte nga shpenzimet kapitale janë investuar 2 milionë e 836 mijë e 132.19 euro. Për mirëmbajtjen verore të rrugëve janë investuar 306 mijë e 105.05 euro. Në mirëmbajtjen e ndriçimit në qytet dhe fshatra janë investuar 297 mijë e 401.12 euro.

## Për një javë 2 296 për kundërvajtësit në komunikacion në rajonin e Prizrenit

PRIZREN, 2 PRILL - Drejtoria Rajonale e Policisë Prizren, Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor dhe stacionet policore të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prizren, gjatë periudhës kohore 26.03.2024-01.04.2024, në vazhdën e implementimit të planit operativ "Siguria në trafikun rrugor" dhe "Sezoni dimëror 2023", kanë realizuar aktivitete në zonën e përgjegjësisë që mbulon katër komuna.
Gjatë kësaj periudhe janë shqiptuar dy mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë (2296) gjoba për kundërvajtësit të cilët kanë rënë ndesh me ligjin për rregullat e trafikut rrugor. Po në kuadër të këtij plani janë ndërmarrë aktivitete edhe në: hetimi i tridhjetë (33) aksidenteve të komunikacionit me dëme materiale, hetimi i shtatëmbëdhjetë (17) aksidenteve të komunikacionit me të lënduar, shqiptuar masa e ndalim-drejtimit të mjeteve për trembëdhjetë (13) ngasës.
Njësitet policore të Drejtorisë Rajonale të Policisë Prizren




vazhdojnë të mbajnë pika të shumta të kontrollit të automjeteve me qëllim të pranisë sa më të madhe në terren dhe parandalimit të aksidenteve të komunikacionit rrugor, me theks të veçantë të aksidenteve me fatalitet.

## Përurohet Reparti i Pediatrisë në Spitalin e Mitrovicës



MITROVICË, 2 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, së bashku edhe me drejtorin e Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar, Elvir Azizin, kanë bërë sot përurimin e Repartit të Pediatrisë në Spitalin e Mitrovicës.
Ata janë mirëpritur nga ushtruesja e detyrës së drejtoreshës së Spitalit të Përgjithshëm të Mitrovicës, Laura Nushi, së bashku me drejtorin e Repartit të Pediatrisë, Qenan Çabra dhe stafin shëndetësor. Së bashku kanë vizituar edhe ambientet e reja të repartit.
Për funksionalizimin e tij janë shpenzuar rreth 1 milion euro, prej të cilave rreth gjysma e shumës është donacion nga Shoqata "Nëna Terezë" që operon në Gjermani me udhëheqës Shaqir Gashin dhe Shoqata "Jetimat e Ballkanit", me udhëheqës Halil Kastratin.
Nga investimi i përgjithshëm, rreth gjysma e investimit është për infrastrukturë dhe inventar, ndërkaq gjysma tjetër është për pajisjet moderne mjekësore.
Reparti ka 11 dhoma, dhomë për mjekim intensiv dhe 25 shtretër për hospitalizim. Reparti i vjetër kishte vetëm një dhomë me shtatë shtretër.

## "Mirënjohje Presidenciale" për ekipin e Fakultetit Juridik që doli i treti në garën botërore

PRISHTINË, 2 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka dhënë "Mirënjohje Presidenciale" për ekipin e Fakultetit Juridik që doli i treti në garën më prestigjioze të drejtësisë në botë. "Ata janë personifikimi më i mirë i rinisë sonë - të talentuar, të motivuar e të përkushtuar për të arritur çdo sukses e për ta ngritur lartë e më lartë shtetin tonë. Prandaj sot, në prezencë të disa prej ish-pjesëmarrësve të garës VIS moot, shumë prej të cilëve edhe kisha nderin t'i trajnoja për rreth 15 vite, si dhe të ekipeve më të reja të Universitetit tonë, e mbi të gjitha në prezencë të prindërve të studentëve, shprehëm sërish mbështetjen dhe krenarinë tonë për studentët tanë", ka shkruar Osmani në "Facebook".



## Presidentja Osmani: Djegia e fëmijëve të Kosovës për së gjalli është e vërteta e Serbisë

Prishtinë, 2 prill - Presidentja Vjosa Osmani ka përkujtuar 25-vjetorin e masakrës në shtëpinë e familjes Vejsa. "Emrat e fëmijëve dhe grave martire të familjeve: Vejsa, Caka, Haxhiavdija, Nuqi, Hoxha dhe Gashi nga Gjakova, janë kujtim i përhershëm dhe dëshmojnë rrugën e vështirë të aspiratave tona për liri e shtet. 25-vjet më parë, regjimi gjenocidal serb, egërsinë e manifestoi kur vrau e pastaj dogji në bodrumin e shtëpisë së familjes Vejsa anëtarët e këtyre familjeve nga mosha 2 e deri në atë 75 vjeçe", ka shkruar Osmani në "Facebook".
Ai ka theksuar se djegia e fëmijëve të Kosovës për së gjalli është e vërteta e Serbisë, e cila edhe sot vazhdon t'i mbrojë kriminelët që kryen këto krime makabre me qëllim të qartë gjenocidal. "Duke mbajtur gjallë kujtimin për ta, do ta vazhdojmë betejën për drejtësi. Qoftë i përhershëm kujtimi për të gjithë të rënët për liri!", ka shkruar Osmani.



# Kurti përkujton masakrën e Kralanit: Përgjegjësia dhe e vërteta ndodhen në arkivat e Beogradit zyrtar




Faton DËRMAKU

Gjakovë, 2 prill - Në 25-vjetorin e masakrave të kryera nga forcat e armatosura të Serbisë, kryeministri Albin Kurti, në Kralan të Gjakovës, përkujtoi të vrarët në masakrën ndaj popullsisë civile në këtë fshat. Duke bërë homazhe fillimisht te varrezat e dëshmorëve në afërsi të shkollës "8 Dëshmorët", kryeministri Kurti theksoi se shumica e të vrarëve nga urdhërdhënësit dhe ekzekutorët në Serbi gjatë luftës së fundit në Kosovë ishin civilë të pambrojtur dhe janë po ata çmimi ynë i paguar për lirinë që sot e gëzojmë. "Më vjen shumë mirë që shkolla e mban emrin '8 Dëshmorët', sepse duhet t'ua kujtojmë të gjithë brezave, edhe atyre aktualë, edhe atyre që vijnë pas nesh, edhe fëmijëve që nuk kanë lindur ende e që do të bëhen nxënës në këtë shkollë një ditë, se liria të cilën ne e gëzojmë, shteti të cilin e ndërtojmë dhe e zhvillojmë, i ka rrënjët pikërisht te ky çmim i lartë që e kemi paguar me gjakun e dëshmorëve dhe martirëve të kombit", tha kryeministri.
Kurti vendosi lule te lapidari në të cilën janë të shkruar 88 emra të shqiptarëve, të cilët, siç tha, u vranë sepse ishin shqiptarë dhe dëshironin të jetojnë të lirë në tokën e tyre stërgjyshore. "Nga mijëra banorë nga rajoni të grumbulluar në Kralan, të ndarë burrat prej grave dhunshëm nga forcat serbe, u vranë 86 civilë të paarmatosur, derisa rrugës për deportim në Shqipëri u vranë dy të tjerë. 11 nga viktimat e këtij krimi kanë qenë fëmijë, ndërkaq 18 prej të vrarëve janë gjetur në afërsi të liqenit Peruçac në Bajina Bashta të Serbisë. Fakti që kriminelët i kanë vrarë shqiptarët dhe ua kanë rrëmbyer kufomat, tregon se sa shumë ata janë përgjegjës për këtë krim të dyfishtë", andaj kryeministri theksoi se përgjegjësia dhe e vërteta ndodhen në arkivat e Beogradit zyrtar të cilët duhet t'i kthejnë mbi 1 600 trupat e më të dashurve tanë, të cilët vazhdojnë të mungojnë edhe 25 vjet më vonë. "I bëjmë thirrje edhe faktorit ndërkombëtar që të bëjë trysni mbi Beogradin, në mënyrë që të ketë drejtësi për Kosovën, për viktimat e shumta gjithandej, të pranverës së vitit 1999, meqenëse pa drejtësi plaga vazhdon të kullojë e familjet e martirëve vazhdojnë të kenë ankth e vuajtje, meqenëse shumë prej tyre nuk e dinë se ku i kanë trupat e pajetë të më të dashurve të tyre", përfundoi kryeministri Kurti.
Dëshmitarët kanë rrëfyer se si mes 2 dhe 4 prillit të vitit 1999 forcat ushtarake dhe policore të Serbisë torturuan qindra burra dhe djem shqiptarë, të rrethuar me tanke në një fushë në Kralan. Pas dy ditësh rrahje e keqtrajtim, më 4 prill, nga grupi i djemve dhe burrave, të cilët janë mbajtur në livadh, gjatë gjithë kohës të rrethuar me tanke, pa ujë dhe pa ushqim, një numër i madh i tyre është liruar. Janë mbajtur 86 prej tyre, ndër të cilët edhe 11 të mitur. Që nga ajo ditë askush nga ta më nuk është parë i gjallë.

## Kurti përkujton edhe të vrarët në shtëpinë e familjes Vejsa në Gjakovë

Pas homazheve në Kralan, kryeministri Albin Kurti vazhdoi drejt qytetit të Gjakovës, për të bërë homazhe te varrezat e të vrarëve nga familja Vejsa, Hoxha, Haxhiavdija, Caka, Gashi dhe Nuçi, në përkujtim të 25-vjetorit të masakrës nga forcat e armatosura serbe.
Në shënim të kësaj date të dhimbjes historike për familjarët e familjes Vejsa, kryeministri Kurti deklaroi se vrasja e fëmijëve, foshnjave, pleqve dhe plakave, e grave, e civilëve të pambrojtur, është dëshmi e gjenocidit nga ana e Serbisë e cila u përpoq ta shfarosë popullin e Kosovës. Teksa shprehu mirënjohjen e tij për forcën e familjeve, kryeministri Kurti theksoi se duhet të adresohen me urgjencë krimet e kryera gjatë luftës përderisa dëshmitë dhe dëshmitarët janë të gjallë. Ai tha se plagët po vazhdojnë ende të kullojnë përderisa nuk ka drejtësi.

## Një vit nga marshi për drejtësi në mbështetje të çlirimtarëve, Krasniqi: Deri në ditën e madhe të lirisë jemi krah tyre

Prishtinë, 2 prill - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se sot një vit dhjetëra mijëra qytetarë të Kosovës, nga të gjitha qytetet e fshatrat, zbarkuan në sheshin e Prishtinës për të marrë pjesë në Marshin për Drejtësi në mbështetje të heronjve tanë të luftës dhe paqes. "Ballafaqimi i dinjitetshëm i çlirimtarëve tanë me drejtësinë, për pastërtinë e luftës tonë për liri, po vazhdon edhe sot. Tashmë po bëhen rreth tri vite e gjysmë nga fillimi i këtij procesi. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi dhe bashkëluftëtarët e tyre, po bëjnë atë që kanë bërë më së miri gjatë gjithë jetës - mbrojtjen e Kosovës, pavarësisht rrethanave dhe çmimit personal. Besa, nuk ka



se si të jetë ndryshe për këta burra, të cilët, përveç lirisë, s'kanë pasur një mision të dytë dhe përveç çlirimit e pavarësisë, s'kanë pasur tjetër projekt rezervë. Një herë patriot - gjithmonë patriot. Deri në ditën e madhe të lirisë së tyre - jemi me ta dhe krah tyre në çdo hap. Drejtësia do të triumfojë, ashtu siç edhe dielli do të lind përsëri!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook"

# Bien eksportet: Prodhuesit thonë se kanë kërkesa, por jo kushte

**Prishtinë, 2 prill** - Sikur industria e prodhimit të kishte më shumë hapësirë për ta ushtruar aktivitetin e saj, vlera e eksporteve të Kosovës do të rritej dukshëm, thotë sipërmarrësi Bujar Rama. Prej vitesh ai udhëheq kompaninë "Behari" në Drenas, e cila merret me prodhimin e dyerve të garazheve. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", ai thotë se kompania e tij nuk ka kapacitete t'u bëjë ballë të gjitha kërkesave për eksport, ndaj kërkon mbështetjen e institucioneve.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Kosovës thotë se bizneset janë mbështetur me qindra miliona euro vitin e kaluar me qëllim të rritjes së eksporteve. Por, pavarësisht prej kësaj, vlera e tyre ra në vitin 2023 krahasuar me një vit më herët.

## Sa ishte vlera e eksporteve?

Kosova përballet me deficit të lartë tregtar prej vitesh, që do të thotë se importon shumë më shumë sesa që eksporton. Mesatarisht në vit ajo importon mallra në vlerë prej 5 miliardë eurosh, ndërsa eksporton nën 1 miliard.

Vitin e kaluar shifra e eksporteve ra në rreth 820 milionë euro nga rreth 920 milionë sa ishte në vitin 2022, apo për rreth 100 milionë, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës.

Zyrtarisht nuk jepet asnjë informacion se përse ka ndodhur kjo.

Nga viti 2019 deri në fund të korrikut 2023, vlera e mallrave të importuara nga Kosova ka arritur në mbi 20 miliardë euro. Gjatë së njëjtës periudhë kohore eksportet e shtetit ishin pak më shumë se 3 miliardë euro.

Ministria e Industrisë thotë se është duke e përmbushur programin e qeverisë për vitet 2021-2025, i cili parasheh "angazhim e përkrahjes" së industrisë prodhuese, përkatësisht "krijim të kushteve të favorshme, investime në kapacitete prodhuese, avancim të teknologjisë prodhuese dhe përpunuese" e të tjera. "Vetëm gjatë vitit të kaluar janë mbështetur 71 biznese për blerje të makinerive prodhuese, në vlerë prej 1.7 milion eurosh, ndërsa 400 milionë euro janë ndarë në formë subvencionimi për dhjetë kompani përfituese, me qëllim të rritjes së eksportit", thuhet në një deklaratë të Ministrisë së Industrisë dhënë "Radios Evropa e Lirë".

Për këtë qëllim, sipas kësaj ministrie, edhe 100 kompani të tjera prodhuese janë përkrahur për pjesëmarrje në 18 panaire ndërkombëtare, "duke promovuar mbi 900 produkte, shërbime dhe paketa turistike në vlerë prej 1.3 milion eurosh".

Përmes një njoftimi më 27 mars, kjo ministri u bëri thirrje ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, që të aplikojnë për grante këtë vit, në vlerë prej 2.5 milionë eurosh.

Ministria nuk iu përgjigj kërkesës së "REL"-it për t'i komentuar pretendimet e sipërmarrësit Bujar Rama, i cili thotë se, për dy vjet, ka kërkuar prej saj që t'i japë në shfrytëzim hapësirë më të madhe për ushtrimin e veprimtarisë biznesore.

## Bizneset duan mbështetje më të madhe

"Sikur të më ndihmonin institucionet", Rama thotë se vlera e eksporteve të tij jashtë Kosovës do të trefishohej. Ai nuk dëshiron të tregojë se sa eksporton brenda një viti, por thotë se kërkesat për prodhimet e kompanisë së tij, qoftë nga vendet e rajonit, qoftë nga ato të Bashkimit Evropian, janë në rritje.

Kompania e tij gjendet në Parkun e Biznesit në Drenas - pjesa qendrore e Kosovës.

Ky park u ndërtua në vitin 2010 nga Ministria e Industrisë, e cila ofroi infrastrukturë fizike për bizneset, si: rrugë, rrymë, ujë e kanalizim.

Aktualisht, në këtë sipërfaqe prej 24 hektarësh janë të vendosura 41 biznese me veprimtari të ndryshme.



Kompania e Ramës zuri vend aty nga viti 2011, në një sipërfaqe prej 1 200 metrash katrorë, dhe ka 60 punëtorë. Ai thotë se me kalimin e viteve ka rritur si kapacitetet prodhuese ashtu edhe numrin e punëtorëve, dhe se ka kërkuar një hapësirë më të madhe për shfrytëzim - deri në 3 500 metra katrorë - për t'i plotësuar, siç thotë, kërkesat në rritje të klientëve.

Për këtë qëllim thotë se iu drejtua edhe Ministrisë së Industrisë.

Por, "të gjitha kërkesat janë zvarritur, nuk më kanë dhënë hapësirë tjetër", thotë Rama. Ai tregon se, së voni, ka blerë vetë sipërfaqen që i nevojitet dhe pajisjet në vlerë prej më shumë se 400 mijë eurosh. Për sistemimin e tyre thotë se i është dashur të marrë një objekt me qira. "Nuk e di kur mund ta ndërtoj [objektin e ri], për shkak të procedurave të shumta për leje. Sikur shteti të më ofronte kushte, do ta rrisja tashmë vlerën e eksportit, do të punësoja numër më të madh të punëtorëve, e jo të merrem me ndërtime", thotë Rama.

Kujtim Gjevori, anëtar i Bordit të Klubit të Prodhueseve të Kosovës, pohon se mungesa e hapësirës është një nga sfidat e shumë kompanive prodhuese. Sipas tij, Ministria e Industrisë përpiqet që në një park biznesi të vendosë sa më shumë kompani - "vetëm për numra". "Më e leverdishme do të ishte t'u jepej më shumë hapësirë kompanive që i kanë siguruar tregjet ndërkombëtare, edhe nëse janë në numër më të vogël", thotë Gjevori për "Radion Evropa e Lirë". Ai shton se edhe kompania e tij "Scampa", e cila merret me prodhimin e qeseve të plastikës dhe gjendet në Parkun e Biznesit në Drenas, ka mungesë hapësire.

Sipas tij, vullneti i institucioneve për t'i ndihmuar bizneset nuk mungon, porse ato "nuk arrijnë t'i identifikojnë kompanitë e duhura për mbështetje". "Sepse çdo qeveri mundohet të bëjë numra, ndihmon kompanitë fillestare... Kjo është mirë, sepse edhe ato rriten dhe zhvillohen, por prioritet duhet të jenë lehtësirat për kompanitë prodhuese që kanë arritur t'i sigurojnë tregjet ndërkombëtare dhe t'i ruajnë ato", thotë Gjevori. Këtu, sipas tij, "qëndron edhe problemi" me rënien e eksporteve.

## Pse janë të rëndësishme eksportet?

Eksportet përfshijnë ato mallra që prodhohen brenda territorit të një vendi dhe, rrjedhimisht, janë pjesë e të ardhurave kombëtare.

Eksportet dhe një bilanc pozitiv i tregtisë janë faktorë të rëndësishëm për suksesin dhe rritjen e ekonomisë së vendit.

Në Kosovë janë rreth 2 400 kompani prodhuese, por vendi importon shumë më shumë sesa që eksporton.

Në raportin "Identifikimi i produkteve me potencial për eksport dhe zëvendësim të importit", i publikuar nga Ministria e Industrisë në tetor të vitit 2023, thuhet se në vitin paraprak produktet që janë eksportuar më së shumti kanë qenë: dyshekët, pllakat, dyert, dritaret dhe kornizat e tyre plastike.

Në raport përmendet, po ashtu, se janë identifikuar 36 prodhime të tjera potenciale për zëvendësimin e importit. Shumica e tyre janë në kategorinë e ushqimeve e pijeve dhe pasohen nga prodhimet e drurit dhe tekstilit.

Eksportet e Kosovës përqendrohen më së shumti në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Gjermani, Zvicër dhe Shtete të Bashkuara të Amerikës.

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se vitin e kaluar vendi ka importuar produkte në vlerë prej 5.7 miliardë eurosh.

Importet vijnë kryesisht nga vendet fqinje dhe ato të Bashkimit Evropian dhe përfshijnë një gamë prodhimesh - nga ushqimore deri tek ato ndërtimore. Për këtë vit, Banka Botërore parashikoi rritje të prodhimit të brendshëm bruto në Kosovë për 3.9 për qind.

# Protestë e punëtorëve të Telekomit pas bllokimit të llogarisë së kompanisë

**Prishtinë, 2 prill** - Pjesëtarët e Federatës Sindikale të Telekomit të Kosovës kanë protestuar të martën, më 2 prill, para objektit kryesor që shfrytëzohet prej Telekomit në Prishtinë si shenjë pakënaqësie për mosmarrje të pagës së muajit shkurt. Llogaritë e Telekomit të Kosovës janë bllokuar në fund të muajit shkurt si pasojë e një borxhi në vlerë të disa miliona eurove ndaj kompanisë tjetër telefonike Z-Mobile. Menaxhmeti i Telekomit pati deklaruar se më 29 shkurt 2024 Telekomi kishte marrë njoftim për bllokim të llogarive.

Në protestën e së martës, Federata Sindikale e Telekomit të Kosovës, përveç kërkesës për zhbllokim të llogarive, ka kërkuar që Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës të bëjnë presion publik për hetim ligjor për dëmet që, sipas sindikalistëve, po i shkaktohen Telekomit. "Kërkoj nga Kolegji i Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale - sepse i ka mundësitë ligjore - sa më shpejt të marrë një vendim, sepse ne besojmë fuqishëm në vendimin e shkallës së dytë, sepse dy herë e kanë sjellë vendimin pozitiv, të mos na lënë pa paga, pasi pagat janë obligim ligjor me Kushtetutën e Republikës së Kosovës", ka thënë kryetari i Federatës Sindikale të Telekomit, Lamih Balaj, gjatë protestës.

Gjykata Komerciale, në vendimin e shkallës së parë, e pati lënë në fuqi urdhrin përmbarimor, që detyronte Telekomin ta paguante borxhin ndaj kompanisë Z-Mobile. Më vonë, shkalla e dytë e kësaj gjykate e ka kthyer lëndën në rigjykim.



Gjatë protestës së 2 prillit sindikalistët nuk e kanë përjashtuar organizmin e protestave edhe para objektit të Qeverisë dhe Kuvendit të Kosovës, as grevat e përgjithshme të punëtorëve të Telekomit nëse nuk zhbllokohen llogaritë.

# ALI AHMETI QYTETAR NDERI I PRIZRENIT, KRYEQYTETIT SHPIRTËROR TË SHQIPTARËVE DHE I SELISË ALTERNATIVE TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË USHTRISË ÇLIRIMTARE KOMBËTARE





Ismet SYLEJMANI

Udhëheqësi i popullit shqiptar nga Maqedonia e Veriut Ali Ahmeti, në Qytetin historik të famëmadhes Lidhja Shqiptare e Prizrenit, por edhe të Kuvendit më famkeq të Kosovës, që i anuloi vendimet e Konferencës së Bujanit, dhe aneksoi Kosovën e nuk lejoi të bashkohej më Shqipërinë, u shpall Qytetar Nderi!

Do të mbetet një ngjarje e madhe dhe e shënuar në historinë kombëtare, politike dhe patriotike, shpallja Qytetar Nderi i Prizrenit të Ali Ahmetit, këtij biri të madh, figurës së jashtëzakonshme dhe personalitetit të shquar të kombit tonë!

Lideri i përmasave të mëdha kombëtare Ali Ahmeti, i cili gjithnjë po shkon duke u rritur dhe duke u bërë më i madh e më i madh, i dashur e i pranuar nga të gjitha shtresat e popullit shqiptar, e morri qelsin e Prizrenit, Qytetit të Unitetit të Kombit Shqiptar!



Ushtari e Komandanti lavdimadh, politikani patriot, largpamës e mendjendritur Ali Ahmeti, me historinë heroike, çlirimtare dhe liridashëse të Qytetit të Prizrenit, është rritur dhe është burrëruar, është kalitur dhe ka shënuar suksese, sepse aty kanë lënë gjurmët e tyre, idhujt e Tij të Lidhjes, Abdyl Frashëri e Ymer Prizreni e deri te kryepersonazhi i Kuvendit më famkeq të Kosovës, pas Luftës së Dytë Botërore, Tribuni i Kombit Ramiz Cernica i cili nuk u dorëzua, edhe pse u tradhëtuan Vendimet e Konferencës së Bujanit, por denoncoi hapur orekset grabitqare dhe shovene të Jugosllavisë dhe Serbisë pushtuese!

Por edhe pas disfatave e humbjeve që na i shkaktonin armiqt, bijtë e mëdhenj, vazhduesit besnik të idealeve të liridashësve, që dilnin nga gjiri i popullit, Atdheut e Kombit tonë të panënshtruar, Lidhja dhe historia titanike e Prizrenit, përsëri vazhdonte të i mbante gjallë!

Prizreni Qyteti legjendar i historisë së lavdishme të popullit shqiptar, ishte Selia e Lidhjes Shqiptare kundër Perandorisë Osmane, ishte Selia e Kuvendit më famkeq të Kosovës së pushtuar nga Jugosllavia titiste, por edhe Selia Alternative e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare!

Nderi i Qytetit të Prizrenit Ali Ahmeti, është edhe Nderi i Bashkisë së Tropojës, dhe sigurisht se kjo dëshirë e qyteteve, kryeqyteteve dhe krahinave të ndryshme shqiptare nuk do të ketë ndalur, sepse Ali Ahmeti do të behet Qytetar Nderi, pra Nderi i qyteteve, dhe në të ardhmen do të jemi dëshmitarë të organizimit të evenimenteve ku do të nderohet ky burrë dhe ikonë e madhe e kombit, i cili është vazhdues i drejtpërdrejtë i platformës euroatlantike të Gjergj Kastriot Skenderbeut dhe të gjithë udhëheqësve të tjerë të mëdhenj të popullit, Atdheut e Kombit tonë!

**Prishtinë, 2 Prill 2024!**







# Shpërndarja e Kuvendit dhe zgjedhjet e parakohshme



Nga Bekim ÇOLLAKU

Shpërndarja e Kuvendit të Kosovës dhe organizimi i zgjedhjeve të parakohshme janë angazhimet e vetme të partive politike parlamentare në këtë periudhë. Në fakt, këto duket e se janë temat e vetme të cilat i bashkojnë partitë opozitare me partinë në pushtet. Së paku, perifrazimi i deklaratës së kryeministrit se "është i gatshëm për t'i ndihmuar partitë opozitare për të votuar një mocion për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës dhe mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme" mund të jetë premtimi i vetëm që ai mund ta realizojë gjatë mandatit të tij. Kjo situatë duhet të qartësohet shumë shpejt, sepse Kosova aktualisht është e bllokuar dhe nën sanksione. Prandaj, partitë politike opozitare të cilat vërtetë janë të interesuara për zgjedhje të parakohshme, nuk mund ta përdorin këtë situatë për të provuar për ta poshtëruar kryeministrin aktual duke insistuar në dorëheqjen e tij, apo votimin e një mocioni mosbesimi kundër qeverisë aktuale. Insistimi eventual në këtë dy opsione i cilës do parti opozitare, është tregues i qartë se ato nuk janë të gatshme dhe të interesuara për zgjedhje të parakohshme. Prandaj, opsioni i vetëm real dhe i mundshëm, i cili ruan në një masë edhe fytyrën e kryeministrit, mirëpo edhe siguron mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, është shpërbërja e Kuvendit të Kosovës pa humbur kohë. Gjithçka tjetër, është humbje kohë në dëm të Kosovës dhe qytetarëve të saj. Zgjedhjet e parakohshme do të kenë kuptim të plotë ligjor dhe praktik vetëm në rast se ato mbahen brenda një periudhe shumë të shkurtër, në të kundërtën, kjo qeveri duhet ta përfundojë deri në fund mandatin e saj.

Përderisa, partia në pushtet duket se është e gatshme për zgjedhje, së paku në mënyrë deklarative, e njëjta gjë ende nuk mund të thuhet edhe për partitë opozitare. Kështu, në njërën anë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) kërkon dhe insiston në dorëheqjen e kryeministrit si opsion për zgjedhje të parakohshme. Në anën tjetër, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kërkon votimin e mocionit të mosbesimit ndaj kryeministrit dhe qeverisë. Këto dy opsione janë turpëruese për kryeministrin dhe qeverinë, prandaj si të tilla, edhe të papranueshme. Prandaj, duket se barra e arritjes së një konsensusi politik për të mundësuar zgjedhjet e parakohshme, i mbetet Partisë Demokratike të Kosovës (PDK). Në çdo rrethanë, kjo paqartësi do të marr fund në momentin kur do të kërkohet votimi për shpërndarjen e kësaj legjislature. Në çdo rrethanë, mbajtja e zgjedhjeve parlamentare të rregullta apo të parakohshme nuk është larg. Prandaj, brenda këtij konteksti politik zgjedhor, sytë e qytetarëve, sytë e votuesve janë te drejtuar tek partitë politike dhe programet e premtimet e tyre për këto zgjedhje. Realiteti i hidhur aktual është se Kosova po ballafaqohet me sfida të mëdha politike, ekonomike dhe sociale. Kosova ndodhet nën sanksione të vendosura nga BE-ja dhe relacionet zyrtare të qeverisë aktuale me partnerët tanë strategjikë, sidomos me SHBA-të kanë shënuar pikën më të ulët dhe alarmante në historinë tonë më të re. Prandaj, zgjedhjet e parakohshme dhe një qeveri e re, që nënkupton edhe një kryeministër të ri, janë mundësia e vetme për reflektuar një dritë shpresë në horizont.

Në kohën kur Kosova qeveriset nga një qeveri e dobët dhe një kryeministër populist e demagog të cilit i mungon vizioni strategjik, është jetike që të kemi një alternativë të qëndrueshme dhe të besueshme, për të drejtuar vendin drejt një të ardhmeje më të ndritur. Kosova dhe qytetarët janë të lodhur nga kryeministri aktual, i cili shpesh përdorë retorikën populliste për të mbuluar mungesën e veprimeve konkrete. Mbi të gjitha, qytetarët duan një kryeministër dhe qeveri që i rregullon problemet e shumta më të cilat ata ballafaqohen çdo ditë. Nuk ka më kohë për të humbur.

Duke analizuar kontekstin aktual politik dhe forcën e katër partive kryesore parlamentare në vend, është e qartë se risia dhe ndoshta shpresa e vetme për ndryshim, është kandidatura e z. Bedri Hamza për kryeministër të Kosovës. Kështu, në zemrën e Ballkanit, një vend i vogël, por me ëndrra të mëdha, po përgatitet për një ndryshim transformues. Kosova, një vend me sfida ekonomike dhe sociale të mëdha, por edhe me një popull të palëkundur në shpirt dhe ambicie, është në prag të një epoke të re. Në këtë udhëkryq historik, PDK ka ofruar një zgjedhje që shpreson të sjellë një dallgë të re shprese: Bedri Hamza, njeriu i cili synon të bëhet drita në fund të tunelit për Kosovën.

Bedri Hamza, i cili tani qëndron në timonin e Mitrovicës, është një lider i njohur në skenën politike të Kosovës. Me një historik të pasur si ish-Ministër i Financave dhe ish-Guvernator i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Hamza ka treguar një profesionalizëm, ndershmëri dhe konsistencë të palëkundur në punën e tij. Ai është arkitekti i qetë pas shumë reformave të suksesshme që kanë ndihmuar në stabilizimin dhe rritjen ekonomike të vendit në një kohë të vështirë. Por, çfarë e bën Bedri Hamzan njeriun e duhur për këtë moment historik? Është vizioni i tij, që e sheh Kosovën jo vetëm si një vend që mbijeton, por si një vend që zhvillohet dhe lulëzon. Ai ka dijen dhe aftësitë që të transformojë ekonominë, të forcojë mirëqenien sociale dhe të ndërtojë një të ardhme ku çdo qytetar i Kosovës mund të ndjejë krenari dhe shpresë.

Imagjinoni një Kosovë ku të rinjtë nuk ndjejnë nevojën të largohen për të gjetur mundësi diku tjetër, por ku mund të ndërtojnë ëndrrat e tyre në shtëpinë e tyre. Ku sipërmarrësit janë të inkurajuar dhe mbështetur, ku arsimi dhe shëndetësia janë prioritete dhe ku të drejtat dhe liritë e çdo qytetari janë të garantuara. Zgjedhja e tij si kryeministër nuk do të ishte thjesht një ndryshim në udhëheqje, por hapje e një epoke të re të shpresës, rritjes dhe bashkimit për të gjithë kosovarët. Kosova dhe kosovarët ndodhen në udhëkryq dhe në pritje të një rrugëtimi të ri për të sjellë ndryshimin që Kosova jo vetëm që e dëshiron, por që me të vërtetë e meriton. Ky është momenti ynë të zgjedhim të ardhmen, të zgjedhim shpresën dhe të zgjedhim udhëheqësin që do të na çojë atje. Populizmi dhe demagogjia boshe nuk e dërgon dot Kosovën në drejtimin e duhur. Një kryeministër i dëshmuar për profesionalizim, ndershmëri dhe i përkushtuar për të punuar dhe shërbyer mund ta bëjë këtë. Por në këtë rrugëtim të ri duhet të jemi bashkë sepse vetëm kjo na bën të pandalshëm për të ndërtuar një të ardhme më të ndritshme për Kosovën.

# DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (13)



Prof. dr. Sabit SYLA &
Prof. dr. Hamit KABA

**-65-**
**Konfidenciale**

A. E. Montgomery
Ambasada britanike
EESD
Beograd
FCO 13 korrik 1981
I nderuar Alan,
Kosova: përgjegjësia politike

**Përmbledhje**
1. Shtypi i Beogradit gjatë dy javëve të fundit ka vazhduar presionin ndaj udhëheqjes së Kosovës që të pranojë përgjegjësinë për rritjen e nacionalizmit shqiptar. Disa nga historitë e brendshme për udhëheqjen duket se kërkojnë një lloj reagimi, p.sh., dorëheqje të tjera, por deri tani njerëzit e interesuar presin rastin e volitshëm. Megjithatë, duket se presioni publik ka arritur që të sigurojë publikimin e vlerësimit "sekret" të Kardelj mbi situatën në Kosovë në vitin 1977.

**Detaje**
2. Shtëpia botuese e gazetës "Politika", e cila përfshin gazetën "NIN", ka vazhduar me presionin e saj të rreptë për t'i kërkuar llogari udhëheqjes politike në Kosovë. Në një sulm për këtë çështje, të dyja gazetat "Politika" dhe "NIN" të datës 28 qershor shqyrtuan mënyrën se si po vijonte procesi i diferencimit në Kosovë. Politika e shprehu çështjen hapur: "Si është e mundur që pas çdo gjëje që ka ndodhur, njerëzit mbeten në pozicione përgjegjëse të cilët, për faktin e thjeshtë se janë në krye të institucioneve me influencë, mbajnë përgjegjësinë më të madhe për institucionet në Kosovë?" Gazeta "Politika" dha përgjigjen në vijim: "Në situatën aktuale, ku pushteti është uzurpuar, vendimet janë lënë në dorë të një rrethi të vogël njerëzish dhe përgjegjësia e tyre varet vetëm nga vetëndërgjegjja e tyre. Vetëm ata mund të emërojnë dhe pushojnë nga puna veten e tyre... Mungesa e kritikës dhe vetëkritikës në udhëheqje është një barrë e rëndë për diferencimin në Kosovë". Gazeta "NIN" bëri një analogji ndërmjet mënyrës se si po kryhej procesi i diferencimit dhe spastrimit të radhëve duke filluar nga poshtë-lart. Pas një analize që ishte bërë në një numër komunash, gazeta arriti në përfundimin se procesi po ecte shumë ngadalë për shkak të mungesës së një udhëheqësi të një niveli më të lartë. Gazeta "NIN" kërkoi një koment për këtë nga një anëtar (shqiptar) i Kryesisë së Kosovës, Pljakiç, i cili tha: "kemi vlerësuar LK-në në tërësi, dhe veçanërisht udhëheqjen dhe organizatat në Kosovë, si përgjegjëse, por kjo nuk do të thotë që udhëheqja të japë dorëheqjen në mënyrë kolektive, për arsye se shkalla e përgjegjësisë objektive të individit ndryshon. Përgjegjësia individuale do të konfirmohet në fazën tjetër të veprimit". Gazeta "NIN" u shpreh se të gjithë pyesnin se pse kjo fazë nuk kishte filluar.

3. Shtypi gjithashtu theksoi me ironi fatin e një njeriu i cili pati guximin t'i dërgonte një telegram Kryesisë së LKJ-së, në të cilën ai shprehte mbështetjen për masat e marra kundër nacionalistëve në Kosovë dhe gjithashtu shprehte pikëpamjen se disa udhëheqës kosovarë, në veçanti Bakalli, mbanin përgjegjësi. Ai u dërgua në burg për 60 ditë për gënjeshtrat "duke dëmtuar organet social-politike, të tilla si Komiteti Krahinor [i LK-së]"! Megjithatë, kjo nuk e ka penguar gazetën "NIN" që të publikojë më 12 korrik dy kritika të detajuara të udhëheqjes së Kosovës.

4. Profesor Halit Ternavci, i cili drejton Katedrën e Gjuhës Shqipe pranë Universitetit të Beogradit dhe është kosovar, mori pjesë vullnetarisht dhe kreu intervista pranë "NIN" rreth çështjeve të ndryshme "të pahapura" në procesin e normalizimit në Kosovë. Ai përdori një gjuhë të fortë për udhëheqjen e Kosovës e cila ka vlerë të përsëritet fjalë për fjalë: "Si mund të presim normalizim në Kosovë kur të njëjtit njerëz në pozicione drejtuese, kundër të cilëve thuhet në programin e masave të LKK-së se kohët e fundit kanë vepruar në mënyrë liberale dhe oportuniste, po zbatojnë aktualisht diferencimin? Objektivi i tyre i qartë është t'i kalojnë çështjet në heshtje… Thjesht nuk besoj se situata në Kosovë do të mund të kapërcehet pa një vlerësim të qartë të përgjegjësive individuale të të gjithë kuadrove drejtues të Krahinës… Është kaq absurde që ne i kërkojmë drejtorëve të firmave ose shkencëtarëve, të cilët janë kompromentuar, të lënë punën, ndërkohë që ata të cilët e miratuan punën e tyre janë ende në krye të zonave më të ndjeshme në jetën e Krahinës."

5. Ai më tej trajtoi çështjen e nepotizmit në nivelet më të larta: "Është thjesht e pabesueshme se sa shumë është ndërlidhur një pjesë e shtresës më të lartë politike dhe intelektuale... Është një klan i tërë në të cilin njëri mbron tjetrin, jo për arsye ideologjike ose nacionaliste, por për të mbrojtur interesat familjare."

6. Profesor Ternavci konkludoi: "Prandaj besoj se LKJ-ja duhet të flasë hapur dhe qartë për ngjarjet dhe përgjegjësitë konkrete mbi të gjitha të komunistëve kosovarë; përndryshe situata do të mbetet e vështirë... Është e vështirë vetëm për aq kohë sa nuk flasim hapur dhe është krijuar përshtypja se disa njerëz duan që t'i kalojnë çështjet në heshtje".

7. Kjo është një kritikë shumë e fuqishme por artikulli në vijim i "NIN" e preku më në thelb çështjen. Kontributin nuk e dha ndonjë gazetar, por Milija Kovaçeviç (serb), i përshkruar si delegat nga Kosova dhe kryetar i Komitetit të Financave të Dhomës Federative të Republikave dhe Krahinave, d.m.th. një person me rëndësi. Në një përshkrim të përpunuar me kujdes mbi krijimin e "egoizmit nacional" në Kosovë, Kovaçeviç tregoi se si "armiku i klasës" ishte në gjendje të shfrytëzonte kushtet politike për të depërtuar në LKK në një numër të konsiderueshëm njerëzish. Përpjekje e veçantë u bë për të depërtuar në medien e Kosovës, gjë që shpjegonte heshtjen e këtyre njerëzve për "ngjarje të ndjeshme dhe komprometuese" në radhët e tyre si dhe përpjekjet për të mbajtur medien akoma më larg këtyre ngjarjeve. Përkundrejt këtij sfondi, vazhdoi Kovaçeviç, "njeriu nuk mund të shmangë faktin që këto struktura [d.m.th. politikanët dhe nacionalistët], si rezultat i sjelljes së tyre, e cila nuk mund të quhet kurrsesi një gabim i zakonshëm apo pakujdesi, orientimi i tyre afatgjatë dhe nënvlerësimi prej tyre i rrezikut nga armiku, i dhanë hapësirë një situate politike, të cilën armiku e përdori për llogari të vet jo vetëm pa rrezikuar veten por madje pa asnjë pengesë."

8. Kovaçeviç iu kthye çështjes së mëparshme për t'i kërkuar llogari personave të përfshirë. Më duhet ta citoj atë fjalë për fjalë sepse i shpjegon kaq qartë vështirësitë aktuale në Kosovë: "Në një situatë të tillë, pjesa më e ngushtë dhe më përgjegjëse e strukturës politike, duke përfshirë mbi të gjitha individët më përgjegjës, duket se përbën bazën dhe pengesën më të vështirë. Ata theksojnë pazëvendësueshmërinë e tyre dhe vazhdojnë me këmbëngulje që t'ia kalojnë përgjegjësinë strukturave më të ulëta politike me justifikimin se LK-ja në përgjithësi kishte dobësi në punën dhe vigjilencën e saj dhe se për rrjedhojë ishte pikërisht këtu pesha kryesore e diferencimit politik. Sidoqoftë, problemi i vërtetë është se këto struktura thellësisht burokratike kanë krijuar kohët e fundit lidhje të forta me njëra-tjetrën dhe me njësitë institucionale të dobishme, nga të cilat varen të gjitha klanet me karakter të theksuar krahinor. Është e vështirë për kuadro kaq politikë që të largojnë veten nga pozicionet kryesore me vendim të tyre pasi në këtë mënyrë do t'u duhej të ndryshonin jo vetëm konceptet e tyre, në fakt sensin mbi rëndësinë e tyre, por edhe disa vendime të caktuara afat-gjata dhe të pandryshueshme që ata kanë trashëguar ose që me kalimin e kohës janë bërë pjesë e vetëdijes së tyre... Për këto arsye, është me rëndësi parësore që marrëdhëniet në hierarkinë politike, d.m.th. në udhëheqjen politike, duhet të spastrohen deri në skaj".

9. Kështu, në të tre artikujt mesazhi është i njëjtë, konkretisht që të gjitha elitat më të larta të Partisë duhet të largohen para se të fillojë procesi i vërtetë i normalizimit në Kosovë me njerëz të rinj, të cilët sipas Kovaçeviç janë spostuar në një linjë dytësore politike shumë kohë më parë. Deri më sot, nuk ka pasur asnjë përgjigje nga udhëheqja e Kosovës dhe politikanët federalë nuk kanë marrë asnjë pozicion publik. Megjithatë, është e vështirë të kuptojmë që, në kushtet aktuale, të mund të injorohen këto kritika të hapura dhe pa ekuivoke. Nëse duhet të ketë një riorganizim të udhëheqjes, nuk mbetet shumë kohë para kthimit të studentëve në shtator, kur cilitdo person që të jetë në krye të Kosovës, do t'i duhet të ketë krijuar një kontroll të mirë mbi situatën politike dhe atë të sigurisë.

10. Mund të jetë krijuar njëfarë shprese se presioni publik për veprim do të triumfojë për shkak të publikimit në gazetën "Komunist", gjatë dy javëve të fundit të vlerësimit gjer më sot të papublikuar të Kardelj mbi situatën në Kosovë sipas këndvështrimit të tij në vitin 1977 (përmendur në letrën time të datës 10 qershor). Njohja me këtë informacion ndoshta mund të kishte mbetur çështje e mbyllur nëse dy politikanët Sllovenë, Ribiçiç dhe Smole, nuk do të kishin kërkuar publikimin e këtij informacioni dhe nëse shtypi nuk do t'i kishte mbështetur ata plotësisht. Gazeta "Komunist" është duke publikuar të gjithë tekstin në formë libri së bashku me një fjalim të Titos mbajtur në Kosovë në vitin 1979 ku i paralajmëron ata për rreziqet e nacionalizmit. Ky publikim priret të krijojë një sërë pyetjesh se përse politikanët kosovarë nuk i kushtuan kujdes këtyre paralajmërimeve si dhe do t'i japë shtysë të re kërkesave që ata të mbajnë përgjegjësi për atë që ndodhi. Fakti është se pikërisht gazeta "Komunist" është ajo që mori iniciativën të publikojë miratimin e sugjerimeve në nivelin më të lartë partiak të kësaj forme të presionit publik ndaj udhëheqjes së Kosovës.

I Juaji,
Jemy T. J. Clark
Për dijeni: P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit, FCO

**-66-**
**Kopje për përdorim të kufizuar**
**Ambasada britanike**
Beograd
15 korrik 1981

Ngjarjet e kohëve të fundit në Maqedoni dhe Kosovë

**Përmbledhje**
1. Aktiviteti nacionalist shqiptar vazhdon në Maqedoninë Perëndimore, megjithëse është shprehur më shumë në formën e veprimit përmes fletushkave, bojkoteve dhe sjelljeve të tjera në shkallë të vogël (por të përhapur) sesa përmes trazirave serioze publike. Pkërisht në Kosovë, do të merren masa kundër drejtorit të



TV Prishtinës i cili është përfshirë në një incident armiqësor. Në Ferizaj gjendja e sigurisë mbetet "e ndërlikuar", dhe një rektori i ri dhe dy zëvendësrektorë të rinj janë emëruar në Universitetin e Prishtinës. Ekonomia e Kosovës është në vështirësi të mëdha.

Detaje

**Maqedonia**

2. Midis datave 2 korrik dhe 13 korrik, gazeta "Politika" përmbante raporte të manifestimeve të nacionalizmit shqiptar në pjesë të ndryshme të Maqedonisë Perëndimore. Kështu, në një mbledhje të Komitetit të Tetovës të LK-së (Lidhjes së Komunistëve) është shkruar sërish aktualisht një vlerësim i favorshëm i gjendjes politike/të sigurisë. Ishte zbuluar se 26 persona të dënuar për pjesëmarrje në demonstratat e vitit 1968 kishin rifituar vendet e punës së tyre në fushën e edukimit; në të vërtetë, disa prej tyre ishin futur sërish në Parti. Gjithashtu ishte zbuluar se në vitet e fundit pothuajse 10,000 shqiptarë nga Kosova ishin shpërngulur dhe vendosur në krahinën e Tetovës. Gjatë mbrëmjes së 8/9 korrikut, rrugët e Tetovës ishin mbushur "përsëri" me fletushka që nxisnin shqiptarët të formonin një "grupim politik" dhe në to thuhej se shqiptarët në Jugosllavi nuk kishin të drejta. Ndërkohë në Gostivar, u shfaqën parulla nacionaliste. Në Kërçovë të Maqedonisë klasat e mësimit u bojkotuan për 23 ditë. Në fshatin e Greshnicës u gris dy herë një foto e Titos. U kërcënuan zyrtarë vendas (përfshirë disa shqiptarë) të cilët ishin përfshirë në aktivitete antinacionaliste.

3. Në përgjithësi, këto raporte paraqesin një tablo të nacionalizmit shqiptar mjaft të përhapur, megjithëse në shkallë të vogël, në Maqedoninë Perëndimore i cili është duke shqetësuar në mënyrë të dukshme autoritetet lokale. Sidoqoftë, në Maqedoni gjendja në përgjithësi duket ende "e qëndrueshme" megjithëse ndoshta jo aq "e kënaqshme" sa shprehej se ishte një muaj më parë nga kryeministri i Maqedonisë në intervistën e tij dhënë për gazetën "NIN" (letra e David Miller që është dërguar për ju më 23 korrik, paragrafi 7). Rastësisht, në një notë personale lektori i Këshillit Britanik në Shkup, më tha këtë javë se pronarët e dyqaneve dhe tregtarët e tezgave shqiptare në Shkup e kishin shumë të vështirë për të shitur ndonjë gjë, madje edhe me çmime të zbritura, ndërkohë që njerëz të kombësive të tjera po nxirrnin fitime duke vënë çmime më të larta dhe duke bërë tregti të shpejtë. Kjo situatë dukej se zhvillohej paralel me bojkotin e pronarëve shqiptarë të dyqaneve ndaj serbëve në Beograd (Letra e Klark e datës 10 qershor drejtuar Montgomerit).

**Kosova**

4. Më 11 korrik gazeta "Politika" raportonte se Savan Hiseni, drejtori i TV Prishtinës, dhe Haki Dautaj, i cili deri kohët e fundit kishte qenë kryetar i Kryesisë së Konferencës Komunale të LK-së në Deçan,



duhej të këshilloheshin për "sanksione më të ashpra" pas implikimit të tyre në një incident ku ishte hedhur përtokë një flamur pro Titos përpara një koncerti të organizuar nga TV Tirana. Kjo dukej një akuzë mjaft modeste për t'iu kundërvënë dhe akuzuar një figure si Hiseni, organizata e të cilit është përballë një kritike të rëndë për tendencat e saj nacionaliste, por është një organizatë që ka tërheqje emocionale popullore dhe është më e lehtë për të ndjekur penalisht këtë organizatë sesa akuzat më të gjera dhe më të çliréta të nacionalizmit.

5. Siç raportonte gazeta "Politika" më 6 korrik, gjendja në Ferizaj dhe përreth këtij qyteti ishte ende "e komplikuar" pavarësisht faktit që ishin identifikuar 400 pjesëmarrës në demonstrata armiqësore. Në një mbledhje të konferencës komunale lokale u bënë ankesat tashmë të njohura se "diferencimi" po zhvillohej ngadalë dhe në mënyrë joefikase. Një nga anëtarët e kryesisë së LK-së së Kosovës tha se "sjellja liberale dhe oportuniste" ishte shkaku i gjithë kësaj duke shtuar me pompozitet, por pa dobi se "ne jemi fajtorë për atë që ka ndodhur".

6. Në letrën time të datës 10 korrik dërguar për ju flitet për situatën e turbulluar në Universitetin e Prishtinës. Gazeta "Politika" e datës 17 qershor raportonte se është emëruar një rektor i ri (dr. Minir Dusi). Gjithashtu janë emëruar dy zëvendësrektorë, një serb dhe një shqiptar; rektori serb është zgjedhur unanimisht, megjithëse kjo kishte ndodhur pasi ai ishte "lutur" pa sukses pranë Këshillit të Universitetit që të mos paraqiste emërimin e tij për arsye shëndetësore.

Ekonomia e Kosovës

7. Raportet se si kanë ndikuar trazirat në ekonominë e Kosovës, kanë qenë kontradiktore, por më 14 korrik gazeta "Politika" raportonte se Kryesia e Kosovës dhe Kryesia e LK-së së Kosovës kanë shqyrtuar pozitën ekonomike dhe kanë konstatuar se ajo ishte "tejet e pakënaqshme". Objektivat e vëna për zhvillimin e Kosovës në vitin 1981 nuk po përmbusheshin, gjë që e bëri gjendjen ekonomike "shumë të ndërlikuar". Hapat prapa në të gjitha frontet ishin veçanërisht të dukshme në periudhën pas demonstratave. Gjithashtu, është ngritur një grup pune për të përgatitur një përmbledhje të problemeve për mbledhjen e ardhshme të Kryesisë së LK-së së Kosovës. Një nga oficerët tanë i LE-së Komerciale ishte në Prishtinë javën e kaluar dhe ka mësuar se rishikimi i parashikuar i Planit 1981-1985 që është tërhequr nuk ishte asgjëkund gati dhe se do të punohej me të gjatë gjithë verës.

I Juaji,

Charles Crawford

Oficer Informacioni

**-67-**

**Për përdorim të kufizuar**

UK sekret

Burim delikat

Z. Broomfield,

Për dijeni: M. Rennie, Departamenti i Kërkimit

15 korrik 1981

**Shqipëria**

1. Në vijim të shqetësimeve tona aktuale mund të dëshironi të keni në dorë draft njoftimin e JIC (në fakt drafti i tretë) që pritet të shqyrtohet nga CIG nesër pasdite. Me përjashtim të ndryshimeve të vogla të cilat i kam nënvizuar me laps, z. Montgomery dhe unë jemi në përgjithësi të kënaqur me të, megjithëse pohimi për rëndësinë e Shqipërisë është më pak tingëllues nga sa kemi shpresuar. Por, ky draft njoftim ofron një historik të përditësuar të dobishëm për:

a) përpjekjet tona për të zgjidhur dallimet tona me Shqipërinë;

b) raportet për shëndetin e dobët të Hoxhës;

c) Kongresin e ardhshëm të Partisë këtë vjeshtë.

2. Megjithatë, puna për draftin ka treguar qartë se sa skematike janë njohuritë tona për skenën e brendshme shqiptare. Sipas mendimit tim, mënyra më e mirë për të ndrequr këtë është që gjatë Presidencës tonë të EC-së për Grupin e Punës së Evropës Lindore, të përgatitet një studim mbi situatën në Shqipëri. Në këtë drejtim, duhet të bazohemi shumë tek francezët, italianët dhe grekët (megjithëse përshtypja ime është se ndonëse kanë misione në Tiranë, edhe ata kanë shumë pak dijeni për atë që po ndodh atje). Gjithashtu, mund të konsultohemi edhe me turqit në këtë drejtim.

I Juaji,

J. C. R. Gray

Departamenti Sovjetik & i Evropës Lindore

**-68-**

**Konfidenciale**

Z. Bullard,

16 korrik 1981

**Shqipëria**

1. Keni kërkuar një vlerësim të implikimeve të raportimeve mbi shëndetin e keq të Hoxhës.

2. Prej disa vitesh ka pasur zëra se Hoxha është i sëmurë rëndë. Dalja e tij e fundit publike për të cilën kemi dijeni ndodhi më 1 maj të këtij viti, ku sipas italianëve ai dukej në një formë mjaft të mirë. Megjithatë, zërat e vazhdueshëm për vdekjen e tij të pashmangshme do të jenë të vërteta një ditë. Duke pasur parasysh këtë fakt dhe shqetësimet tona aktuale me përpjekjet e bëra nga ana jonë për të zgjidhur dallimet tona me shqiptarët, si departament po tregojmë më shumë interes për Shqipërinë sesa kemi pasur prej kohësh. Fryti i parë në këtë drejtim është një draft notë i JIC-së, që po përgatitet aktualisht. Paragrafët përkatës citojnë:

a) Pozita e Shqipërisë i jep asaj një rëndësi të pabarabartë me madhësinë dhe pozicionin e saj ndërkombëtar. Rusët kanë arsye të qartë ideologjike për t'i sjellë shqiptarët në vathën e vet. Për më tepër, ata do të përfitonin në mënyrë të konsiderueshme nga kontrolli mbi objektet ushtarake shqiptare, veçanërisht bazën detare, dhe e shihnin si një avantazh përdorimin e Shqipërisë si bazë prej ku do të ushtronin presionin e tyre ndaj Jugosllavisë apo do të nxisnin subversionin apo destabilizimin aty. Interesimi kryesor i Perëndimit është që të mos e lejojë Bashkimin Sovjetik të përdorë objektet ushtarake. Kina ndoshta ka pak më shumë interes në vend.

b) Udhëheqësit shqiptarë deri tani kanë mbetur armiqësor ndaj Bashkimit Sovjetik dhe të shurdhër ndaj thirrjeve të sovjetikëve për përmirësimin e marrëdhënieve. Por, besojmë se gjatë viteve të ardhshme Bashkimi Sovjetik do të vazhdojë përpjekjet për përmirësimin e marrëdhënieve me Shqipërinë, ndërkohë që do të kultivojë lidhje më të ngushta me çdo element prosovjetik që mund të ketë mbetur në vend. Jugosllavët besojnë se Enver Hoxha ka sëmundje të pashërueshme dhe besojnë se fraksionet pro Moskës po synojnë të marrin kontrollin e Shqipërisë pas vdekjes së Hoxhës. Nevoja e ngutshme për ndihmë të huaj mund ta bëjë me të vërtetë ndonjë udhëheqje të re më të bindur ndaj përçapjeve sovjetike për afrim. Por, dallimet e mbetura e madje ndoshta të heshtura ideologjike dhe dëshira për të shmangur paragjykimin e Shqipërisë për përmirësimin e marrëdhënieve me pjesën tjetër të botës, mund të pengojnë zhvillimin e lidhjeve më të ngushta me Moskën.

c) Po të vinte në fuqi në Tiranë një udhëheqje prosovjetike, pa dyshim që Bashkimi Sovjetik do të kërkonte objekte ushtarake në vend, dhe me qëllim që ato të mbeten të sigurta për një periudhë të gjatë kohore, ndoshta do të dëshironte ta tërhiqte Shqipërinë sërish në Komekon, në mos në Paktin e Varshavës. Shqipëria ndoshta do të kërkonte një quid pro quo (kompensim) të rëndësishëm për objektet ushtarake. Rusët mbase do të ishin të përgatitur për të paguar një çmim mjaft të lartë për një marrëdhënie të tillë, megjithëse një barrë shtesë financiare do të ishte jo e mirëpritur për anëtarët e tjerë të Komekon. Një kosto më të madhe do të kishte frenimi i pashmangshëm i përpjekjeve të rusëve për të joshur Jugosllavinë të cilën e shohin qartazi si një çmim më të lartë. Nuk mendojmë se Bashkimi Sovjetik do të ndërmerrte veprime ushtarake për të fituar kontrollin mbi Shqipërinë përveç se po të ftohej nga shqiptarët ose në rastin e një dobësimi të përgjithshëm në Ballkan.

3. Sidoqoftë, njohuritë tona mbi skenën e brendshme shqiptare janë mjaft të vagëlluara. Por, mendojmë se nëse vdes Hoxha pasuesit e mundshëm do të përfshinin Shehun, kryeministrin aktual, megjithëse edhe ai është i vjetër dhe me sa duket i sëmurë. Nga ana tjetër, Byroja Politike përbëhet kryesisht nga shokë të Hoxhës të kohës së luftës të cilët në vazhdimësi kanë mbështetur politikat e tij. Nuk kemi shenja për divergjenca serioze mendimesh brenda Byrosë Politike të cilat mund të sillnin një shenjë të politikave të mundshme të brendshme pas largimit të Hoxhës.

4. Për të plotësuar njohuritë tona mjaft të fragmentuara, kemi parasysh se gjatë Presidencës së EC-së, Grupi i Punës së Evropës Lindore duhet të përgatisë një studim mbi situatën në Shqipëri. Në përgatitjen e këtij dokumenti duhet të mbështetemi fuqimisht tek francezët, italianët dhe grekët (megjithëse përshtypja ime është se pavarësisht se këto vende kanë misione në Tiranë, edhe ata janë të keq-informuar për atë që po ndodh atje). Gjithashtu, mund të konsultohemi edhe me turqit në NATO.

I Juaji,

J. C. R. Gray

Departamenti Sovjetik & i Evropës Lindore




# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Xhudoja e Kosovës, promovimi më i fuqishëm i vlerave tona



**Pejë, 2 prill** - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, është lajmëruar nga Gryka e Rugovës së bashku me disa xhudistë panamezë. Nga atje, Kuka ka thënë se xhudoja dhe xhudistët janë duke i promovuar fuqishëm vlerat e shtetit të Kosovës. Në këtë kontekst, Kuka ka bërë me dije se në këtë muaj mbi 100 garues do të stërviten me ekipin e drejtuar nga ai. "Me pamje fantastike të Grykës së Rugovës! Me ekipin simpatik dhe njerëz pozitiv nga Panama e largët! Xhudo e Kosovës, promovimi më i fuqishëm i vlerave tona. Këtë muaj do kemi afër 100 garues nga mbi 15 shtete në stërvitje me ekipin tonë!", ka shkruar Driton Kuka në "Facebook", trajner i xhudos.

# Sot luhen dy ndeshjet gjysmëfinale të Kupës së Kosovës, FFK-ja cakton gjyqtarët



**Prishtinë, 2 prill (ER)** - Sot (e mërkurë) do të luhen dy ndeshjet gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në Futboll. Do të ballafaqohen Ballkani - Suhareka dhe Prishtina - Drita. Faza gjysmëfinale në Kupën e Kosovës zhvillohet me ndeshjet vajtje-ardhje për dallim nga fazat e kaluara, ku ishte luajtur vetëm nga një ndeshje dhe fituesi kalonte tutje. Me këtë rast, Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) të martën ka caktuar gjyqtarët të cilët do ta ndajnë drejtësinë në dy ndeshjet gjysmëfinale të Kupës së Kosovës.

Ndeshja e parë në mes të Suharekës dhe Ballkanit do të gjykohet nga Alban Shala si kryesor me ndihmës Arbnor Bullatovci dhe Besnik Morina, ndërsa Valon Bajgora do të jetë gjyqtar i katërt. Visar Kastrati do të jetë në VAR së bashku me Edmond Zeqirin.

Në ndeshjen tjetër në mes të Prishtinës dhe Dritës drejtësinë do ta ndajnë Genc Nuza me ndihmësit Bujar Selimaj dhe Fatmir Sekiraqa, ndërsa Mentor Ajeti do të jetë i katërti. Në VAR do të jenë Mervan Bejtullahu dhe Fatlum Berisha. Të dyja ndeshjet fillojnë nga ora 15:00.

# I lindur në Gjermani e rritur në Kosovë, historia e suksesit të Edon Zhegrovës



**Prishtinë, 2 prill** - Edon Zhegrova është duke kaluar një sezon fantastik në fanellën e Lilles. Ai ka hyrë në mendjen dhe zemrat e tifozëve të këtij klubi dhe atyre francezë në përgjithësi. Faqja zyrtare e Ligës 1 i ka kushtuar një shkrim për "Messin e Kosovës", duke treguar historinë dhe rrugëtimin e tij. Së fundmi, Zhegrova ka realizuar dy gola duke ia mundësuar fitoren ekipit të tij. 25-vjeçari ka marrë edhe çmimin "Lojtari i ndeshjes". Futbollisti deri më tani i ka realizuar 5 gola dhe i ka bërë 5 asistime deri tash në 26 takime.

Edon Zhegrova ka lindur në Gjermani, ku prindërit e tij kishin shkuar për t'iu shmangur luftës në Kosovë në vitin 1998. Më pas, ai me familje ishte kthyer në Kosovë kur Edoni ishte dy vjeç, ndërsa në vendin e prindërve kishte nisur të merrej me futboll. "Ishin rrugët e Prishtinës kur Edoni kishte nisur ta shfaqte talentin e tij të pashtershëm, ndërsa shpejt iu bashkua klubit lokal, ku do t'i shënonte rregullisht nga 5-6 gola për ndeshje. Njerëzit filluan ta vinin re menjëherë. Talentin e tij e zbuloi edhe gjiganti italian AC Milan", shkruan "Ligue1.com".

Zhegrova ka folur për rrugëtimin e tij me nostalgji. Ai para disa ditësh ka festuar 25-vjetorin e lindjes.

# MKRS-ja: Projekti i stadiumit nacional paraqitet brenda këtij viti

**Prishtinë, 2 prill** - Fillimi i punëve për ndërtimin e stadiumit nacional të Kosovës pritej të bëhej qysh në vitin 2019, por ky projekt deri sot ende nuk e ka gëzuar një përfundim. Me marrjen e kandidaturës për organizimin e Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, ndër planet e institucioneve vendore është edhe fillimi i ndërtimit të stadiumit nacional.

Ministri i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Hajrulla Çeku, para disa muajve kishte shpalosur planin për ndërtimin dhe rinovimin e 27 stadiumeve në Kosovë, ku pjesë e tyre ishte edhe stadiumi nacional, plan ky që pritet të jetësohet gjatë pesë viteve të ardhshme.

Edhe pse komisioni për vlerësimin e ndërtimit të stadiumeve është formuar, ende nuk dihet asgjë sa i përket ndërtimit të stadiumit nacional, as vendi dhe as koha se kur do të fillojnë ndërtimet.

Zëvendësministrja e MKRS-së, Daulina Osmani, ka bërë me dije se po synohet që projekti i stadiumit nacional të paraqitet brenda këtij viti. Osmani ka bërë me dije se po punohet me



intensitet të lartë në masterplanin dhe në hartimin e kornizës ligjore për Lojërat Mesdhetare Prishtina 2030. "Projekti i Stadiumit Nacional synohet të prezantohet përbrenda këtij viti. Po e quajmë nacional sepse ashtu e kemi etiketuar ndër vite. Po punohet në hartimin e kornizës ligjore për Lojërat Mesdhetare me intensitet shumë të lartë si dhe me masterplanin e Lojërave Mesdhetare, dokument ky i cili do të na kthejë mbrapa të gjitha përgjigjet, qoftë për llojin e investimit, qoftë për koston, mbi të gjitha edhe për lokacionet e duhura të investimeve që do t'u shërbejnë Lojërave Mesdhetare në vitin 2030, mirëpo edhe gjithë

## Tifozëve gjermanë u ndalohet blerja e fanellave me numrin 44, shkak simbolizmi nazist




**Berlin, 2 prill** - Adidas ka ndaluar tifozët e futbollit të blejnë fanellat gjermane të personalizuara me numrin 44, pasi mediet kanë ngritur ngjashmërinë e saj me simbolin e përdorur nga njësitë naziste "SS" të epokës së Luftës së Dytë Botërore. "Ne do të bllokojmë personalizimin e fanellave", ka thënë një zëdhënës i Adidas-it.

Njësitë "SS" ishin më përgjegjëset për krimet kundër njerëzimit të kryera nga nazistët. "Runa SS" është projektuar për t'u përdorur nga njësitë naziste në vitin 1929. Anëtarët e SS varionin nga agjentët e Gestapos deri te rojet e kampeve të përqendrimit. Detyrat e "SS" përfshinin administrimin e kampeve të vdekjes ku miliona hebrenj dhe të tjerë u vranë. Zëdhënësi i Adidasit, Oliver Bruggen, ka mohuar se ngjashmëria e kompletit me simbolet naziste ishte e qëllimshme.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 26.4 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditores së Përgjithshme nr. 326 të datës 27.03.2023, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

**KONKURS**

| | |
|---|---|
| 1. **Pozita:** | **Auditor për teknologji të informacionit** |
| **Numri i referencës:** | ATI/ZKA/04-05/24 |
| **Grada:** | ZKA-A7 |
| **Numri i pozitave:** | Dy (2) |
| **Kohëzgjatja e emërimit:** | Me kohë të pacaktuar |

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Kryen auditime të sistemeve të informacionit në koordinim me UE, sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare dhe i raporton udhëheqësit të ekipit dhe Drejtorit të Departamentit të Auditimit;
- Ndihmon Udhëheqësin e ekipit dhe koordinohet rreth procesit auditues si dhe komunikon/konsultohet rregullisht me UE dhe Drejtorin e Departamentit dhe raporton për arritjen e objektivave sipas planit të aprovuar nga Drejtori i departamentit;
- Kryen hulumtime dhe analizë në fushën e sistemeve të informacionit në sektorin publik dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;
- Merrë pjesë aktive në planifikim/parastudim dhe kryen vlerësimin e rreziqeve për sistemet e informacionit të audituara/monitoruara sipas fushave të përcaktuara nga UE dhe pjesëmarrje në përcaktimin e objektivave, fushës audituese si dhe kritereve dhe metodave të auditimit;
- Komunikon mirë brenda ekipit dhe me entitet, kryen detyrat e përcaktuara nga UE dhe koordinohet në fazat e procesit auditues (planifikim, ekzekutim dhe raportim) dhe merrë pjesë aktive në takime, intervista dhe diskutime me entitetin;
- Kryen hulumtime dhe analiza të sistemeve dhe te të dhënave dhe siguron dokumentimin e tyre si dhe shkrimin e gjetjeve duke përfshirë elementet-kriterin, gjendjen, shkakun dhe efektin/rrezikun. Siguron dëshmi të mjaftueshme duke nxjerrë përfundime/konkluzione të bazuara dhe dhënien e rekomandimeve;
- Përgatitë Letrat e Punës dhe Memo përmbledhëse lidhur me auditimin e fushës/komponentës audituese të përcaktuar nga udhëheqësi. Krijon dosjen/dëshmitë e auditimit dhe bënë indeksimin e tyre sipas kërkesave të UE dhe rregullave të ZKA;
- Ofron mbështetje për UE në hartimin e Draft raportit dhe në proceset e rishikimit (zbatimin e komenteve), në finalizimin e raportit të auditimit dhe aktivitetet pas raportuese si dhe merr pjesë në prezantime dhe seminare ndërlidhur me atë raport;
- Ofron përkrahje dhe bashkëpunim nëse kërkohet në nivel të ZKA-së, në mënyrë që të ofrojë mbështetjen e duhur lidhur me sistemet e TI për fushat që auditohen nga stafi tjetër i zyrës (për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë) si dhe kontribuon në RVA;
- Siguron se aktivitetet audituese kryhen në pajtim me kërkesat e ZKA përfshirë punën e organizuar online/nga shtëpia, zbaton manualet e auditimit dhe siguron se përdoren sistemet e vendosura për auditim në ZKA dhe sistemet e veçanta për auditimet e SI-së;
- Ruan dhe azhurnon njohuritë profesionale dhe teknike përmes trajnimeve dhe Edukimit të Vazhdueshëm Profesional si dhe tregon gatishmëri për të zhvilluar vetveten në fushat e dakorduara me Drejtorin gjatë vlerësimit të performancës;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UE dhe nga Drejtori i departamentit.

**Kualifikimet Themelore:**

- Diplomë fakulteti në fushat relevante të TI-së;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, preferohet përvojë pune në fushën e auditimit;
- Preferohet certifikim për auditor nga fusha e TI-së;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

**Shkathtësitë e kërkuara**:

- Njohuri të theksuara në fushën e auditimeve;
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

**Informata të përgjithshme për kandidatë:**
Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**<u>Procedura e Aplikimit:</u>**
Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

**Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **18.04.2024 ora 16.00.**

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Shënim:**
Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije (izmenjeno i popunjeno Pravilnikom (NKR) Br. 01/2023), vezano za Član 26.4 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu zapošljavanja za 2024. godinu kao i Odluci Generalne revizorke Br. 326 datuma 27.03.2023, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje:

**KONKURS**

| | |
|---|---|
| 1. **Pozicija:** | **Revizor informacione tehnologije** |
| **Broj reference:** | ATI/ZKA/04-05/24 |
| **Koeficijent:** | ZKA-A7 |
| **Broj pozicija:** | два (2) |
| **Trajanje imenovanja:** | Na neodređeno vreme |

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Završava revizije sistema informacije u koordinaciji sa VT, prema godišnjem planu, pravilnicima i metodologiji NKR-a, koda etike i u skladu sa međunarodnim standardima i izveštava vođi tima i direktoru departmana revizije;
- Pomaže vođu tima i koordinira se oko procesa revizije kao i komunicira/konsultuje se redovno sa VT i direktorom departmana i izveštava o dostignućima ciljeva prema odobrenom planu od strane direktora departmana;
- Vrši istraživanja i analize u polju sistema informacija u javnom sektoru i predlaže revizijske teme o strateškom i godišnjem planiranju NKR-a;
- Aktivno učestvuje u planiranju/predstudiji i vrši procenu rizika za revidirane/praćene informacione sisteme prema oblastima definisanim od strane VT i učešće u definisanju ciljeva, oblasti revizije kao i kriterijuma i metoda;
- Dobro komunicira unutar tima i sa subjektom, obavlja zadatke definisane od strane EU i koordinira u fazama procesa revizije (planiranje, izvršenje i izveštavanje) i aktivno učestvuje u sastancima, intervjuima i diskusijama sa subjektom;
- Vrši istraživanje i analizu sistema i podataka i obezbeđuje njihovu dokumentaciju kao i pisanje nalaza uključujući kriterijume-elemente, stanje, uzrok i efekat/rizik. Pruža dovoljno dokaza donoseći zaključke/konkluzije osnovane u davanju preporuka;
- Priprema radne dokumente i sažetke memoranduma koji se odnose na reviziju oblasti/komponente koju definiše vođa. Kreira revizijski fajl/dokaze i vrši njihovo indeksiranje u skladu sa zahtevima VT i pravilima NKR-a;
- Pruža podršku VT-u u izradi Nacrta izveštaja i u procesima pregleda (implementaciji komentara), u završavanju revizorskog izveštaja i aktivnosti posle izveštavanja, kao i učestvuje u prezentacijama i seminarima u vezi sa tim izveštajem;
- Pruža podršku i saradnju ako je potrebno na nivou NKR -a, kako bi se pružila odgovarajuća podrška u vezi sa IT sistemima za oblasti koje revidiraju drugo kancelarijsko osoblje (za finansijske revizije i revizije usklađenosti), kao i doprinos GIR;
- Obezbeđuje da se aktivnosti revizije sprovode u skladu sa zahtevima NKR-a, uključujući organizovani onlajn/kucni rad, implementira priručnike revizije i obezbeđuje da se koriste sistemi uspostavljeni za reviziju u NKR-u i posebni sistemi za revizije IS;
- Sačuva i ažurira stručna i tehnička znanja kroz obuke i kontinuirano stručno obrazovanje, kao i pokazuje spremnost da se razvija u oblastima dogovorenim sa direktorom tokom procene učinka;
- Obavlja i druge stručne poslove na zahtev VT i direktora departmana.

**Osnovne kvalifikacije:**
- Diploma fakulteta iz relevantnih IT oblasti;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti IT, poželjno radno iskustvo u oblasti revizije;
- Poželjna sertifikacija IT revizora;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.

**Potrebne veštine**:

- Savršeno znanje u oblasti revizije;
- Veštine u organizaciji rada i ispunjenju ciljeva;
- Znanje pravnih akata važećih u Nacionalnoj kancelariji revizije;
- Znanje o efektivnom nadzoru profesionalnog rada;
- Sposobnost da bi predstavljali i branili interese institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikativne sposobnosti u timu;
- Dobre međuljudske veštine.

**Opšte informacije za kandidate:**
Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

**Procedura apliciranja:**
Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu

**Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta**:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovana;
- dokazi o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom (ne starija od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (*ako je primenljiva*);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, zadnji rok za podnošenje dokumentacije **18.04.2024** godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

**Beleška:**
Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.

Në bazë të dispozitave të nenit 21, nenit 25 të ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarjet Publike, respektivisht neni 13 të ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L- 087 për Ndërmarjet Publike, si dhe ligjit numër 06/L-021 neni 22 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Komisioni i Auditimit i Ndërmarjes Publike KRM "Pastrimi" Sh.A. në Prishtinë në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2024, mori vendim që të rishpallë, konkursin me afat prej 30 dite per Zyrtarin e Auditimit të Brendshem:

**K O N K U R S**

**Pozita e punës**: Zyrtar/e i Auditimit të Brendshëm - 1 ekzekutues

Vendi dhe lokacioni i Punës: Prishtinë,

Zyrtari i Auditimit të Brendshëm / Nën mbikqyrje të Komitetit të Auditimit

Kohëzgjatja e Kontratës së punës tri (3) vjeçare

**Detyrat dhe Përgjegjësitë:**

- I raportion komisionit të auditimit dhe bordit të drejtorëve për politikat, programet dhe aktivitetet e zyrës.
- Të planifikojë, organizoj dhe mbikqyrë punën e zyrës së Auditimit të Brendshëm, duke përfshirë planifikimin, hartimin dhe menaxhimin e programit për auditim, organizimin dhe delegimin e punëve dhe përllogaritjen e resurseve të nevojshme.
- Përgaditja e planit të punës, zbatimi dhe monitorimi.
- Të monitorojë zbatimin e të gjitha rekomandimeve të Komisionit të Auditimit.
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe fuksionimin e rregullt të kontrolleve të brendshme (duke përfshirë ato financiare), si dhe të raportoj te Komisioni I Auditimit.
- Të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga KRM "Pastrimi" Sh.A të të gjitha ligjeve të aplikueshme ne Kosovë.
- Të propozoj masa që duhet të ndërrmeren nga kompania për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të veprimtarisë.
- Në bazë të planit të auditimit, përgaditë raportet e auditimit për shqyrtim nga Komision i Auditimit.
- Bashkëpunon me zyrtarët e ndërrmarjes në koordinim me Kryeshefin Ekzekutiv.
- Kryen edhe punë dhe detyra tjera te cilat i caktohen nga komisioni i auditimit.

**Kualifikimi, përvoja e punës dhe aftësitë:**

- Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet. master në drejtimet ekonomike me theks në kontabilitet dhe auditim do te jetë përparesi
- Së paku 5 vite përvojë pune menaxhuese në auditim të brendshëm, 5 vite pervoje menaxhuese në auditim të brendshëm konsiderohet përparesi;
- Njohuri dhe përvojë në fushën e auditimeve të deshmohet me kontrata, vendime;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme me theks Ligji per NP dhe I ligjeve qe kane te bejne me kontrollin e brendshem dhe menaxhimin e financave publike;
- Shkathtësi ne komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi kompjuterike ne aplikacione të programeve (word, Excel, Power Point, Access);
- Të jetë i certifikuar në auditim të brendshëm në sektorin publik leshuar nga MEF ose nga ndonje institucion relevant vendor ose nderkombetar si: përparësi është SKAK, etj.

**Paraqitja e kërkesave**

1. Kërkesat dorëzohen në zyrën nr. 8. të KRM "Pastrimi"SH.A, Rr.Tahir Zajmi''nr.5, Prishtinë dhe duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
2. CV, Përvoja e punës e deshmuar me dokumente veçmas deshmi për pervojen menaxhuese ne auditim (dokumente origjinale ose te noterizuara),Vërtetim nga trusti pensional,Diplomat e shkollimit fakultetit (e noterizuar),Diploma nga universitetet e huaja duhet te jete e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit (deshmi e noterizuar), Çertifikata e Auditimit (e noterizuar),Çertifikata e lindjes jo me e vjetër se gjashtë muaj, Kopja e letërnjoftimit, dëshminë se nuk jeni nën hetime jo me e vjeter se gjashtë muaj (origjinali).
3. Deklarata nën betim.
4. Dokumentet e pakompletuara si dhe ato që arrijnë pas afatitit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.
5. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.
6. Konkursi është i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
7. Informata shtesë mund të sigurohen përmes telefonit nr.038/603-191.

Kryesuesi i Komitetit Auditimit
Valon Gogiqi

Prema odredbama člana 21. Zakon br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno član 13 Zakona 04/L-111 o izmeni i dopuni Zakona br. 13. Zakon br. 03/L- 087 o javnim preduzećima, kao i Zakon br. 06/L-021 član 22 o internoj reviziji javnih finansija, Komisija za reviziju javnih preduzeća "Pastrimi" SH.A. U Prištini, na sastanku održanom 29.03.2024. godine, doneta je odluka o ponovnom podnošenju konkursa sa rokom od 30 dana za službenika interne revizije:

**K O N K U R S**

**Radno mesto**: Službenik interne revizije - 1 izvršitelj

Lokacija i lokacija: lokacija

Službenik interne revizije / Pod nadzorom revizorske komisije

Trajanje ugovora od tri (3) godine

**Dužnosti i odgovornosti:**

- Izveštaj Odboru za reviziju i Upravnom odboru o politikama, programima i aktivnostima Kancelarije.
- Planiranje, organizovanje i nadgledanje rada Kancelarije za unutrašnju reviziju, uključujući planiranje, projektovanje i upravljanje programom revizije, organizovanje i organizovanje i Delegacija radova i obračun potrebnih resursa.
- Pripremite plan rada, implementaciju i praćenje.
- Pratite primenu svih preporuka Odbora za reviziju.
- Proverite adekvatnost i redovno funkcionisanje internih kontrola (uključujući i finansijske) i javite se Odboru za reviziju.
- Provera prikladnosti i redovnog funkcionisanja sistema i procedura koje imaju za cilj garantovanje implementacije od strane RM "Pastrimi" Sh.A. svih zakona Primenljivo u Nigeriji.
- Predložite mere koje preduzeće mora preduzeti da bi se povećala efikasnost i efikasnost delatnosti.
- Na osnovu plana revizije, pripremite revizorske izveštaje za razmatranje od strane Odbora za reviziju.
- Sarađuje sa zvaničnicima undertaxa u koordinaciji sa glavnim izvršnim direktorom.
- On takođe obavlja druge poslove i zadatke koje mu je dodelio revizorski komitet.

**Kvalifikacije, radno iskustvo i veštine:**

- Univerzitetska diploma iz ekonomije, prava, javne administracije, javnih finansija, računovodstva.
  Master u ekonomskim pravcima sa akcentom na računovodstvo i reviziju biće napredovanje
- Najmanje 5 godina iskustva u upravljanju internom revizijom, 5 godina iskustva u upravljanju internom revizijom smatra se napretkom;
- Znanje i iskustvo iz oblasti revizije koje treba pokazati ugovorima, odlukama;
- Poznavanje važećih zakona i propisa u skladu sa Zakonom o UN i zakonima koji se odnose na unutrašnju kontrolu i upravljanje javnim finansijama;
- Komunikacione veštine, planiranje rada i vođstvo tima;
- Računarske veštine u softverskim aplikacijama (word, Excel, Power Point, Access);
- Budite sertifikovani u internoj reviziji u javnom sektoru koju razmatra MEF ili bilo koja relevantna lokalna ili međunarodna institucija kao što je: prioritet je SKAK, itd.

**Prosleđivanje zahteva**

1. Zahtevi se podnose kancelariji br. 8. KRM za "Pastrimi". SH.A, Tahir Zajmi" 5 St., Priština i ova dokumenta moraju biti priložena:
2. CV, Radno iskustvo demonstrirano sa posebnim dokumentima dokaz za iskustvo menadžmenta u reviziji (originalna ili notarizovana dokumenta), Potvrda o penzijskom poverenju, Diploma fakultetskog obrazovanja (notarizovana), Diploma sa stranih univerziteta mora biti obaveštena od strane Ministarstva prosvete (notarizovani sertifikat), Izvod iz revizije (notarizovan), Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci, Kopija ID-a, dokaz da niste pod istragom ne stariji od šest meseci (original).
3. Deklaracija nën prikaz.
4. Nepovezana dokumenta i oni koji stignu posle isteka roka za takmičenje neće biti razmatrani.
5. Biće kontaktirani samo kandidati koji su ušli u uži izbor.
6. Konkurs je otvoren 30 dana od dana objavljivanja u dnevnoj štampi.
7. Dodatne informacije možete dati telefonom 038/603-191.

Predsednik Odbora za reviziju
Valon Gogići

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “OSK Brokers” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811995383 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “OSK Brokers” D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811995383 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “OSK Brokers” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811995383 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.












## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Atdhe Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Leonard Nrecaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Gresa Grajqevci shpall të pavlefshme ID-Kartelën e Kolegjit AAB Prishtinë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.


100% Fresh & Natural
VIDAS
Llatte drink
2%
VIDAS
TAMËL
PRODHUAR ME FINESË DHE DASHURI
2,8%
VIDAS
Schmand
ajkë e freskët sour cream
18% yndyrë
800g
VIDAS
JOGURT
VIDAS
DHALLË


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES